COBISS

COMARC/A
Formati për të dhënat e njësuara

Manual për përdoruesit

United Nations
Educational, Scientific and
Cultural Organization

Regional Centre for
Library Information Systems and
Current Research Information Systems
Regionalni center za knjižnične
informacijske sisteme in informacijske
sisteme o raziskovalni dejavnosti

IZUM

© IZUM, 2023
Titulli origjinal: COMARC/A Format : za normativne podatke; shtator 2023

COBISS, COMARC, COBIB, COLIB, IZUM janë marka të regjistruara në pronësi të institucionit publik IZUM.

Marka të tjera të përdorura janë me pronësi tjetër.

Manuali përmban të gjitha përditësimet nga botimi i versionit të parë në vitin 2003 deri sot. Përmbajtja është në përputhje me programin COBISS3, V13.0 dhe COBISS4/Katalogimi, V1.2, ndërsa vlenë për të gjitha versionet në vazhdim të programit, deri në anulimin ose botimin e versionit të ri të manualit në formë elektronike.

© IZUM, ndryshimet e fundit të përmbajtjes: shtator 2023, përkthimi në gjuhën shqipe: nëntor 2023

ISSN 2463-9672

PËRMBAJTJA

HYRJE ..... HYRJE - 1

0XX BLLOKU I IDENTIFIKIMIT ..... 0XX - 1
001 Etiketa e regjistrimit ..... 001 - 1
010 Identifikuesi Standard Ndërkombëtar i Emrave (ISNI) ..... 010 - 1
017 Identifikues të tjerë ..... 017 - 1
035 Numrat e kontrollit të regjistrimeve në sistemet e tjera ..... 035 - 1

1XX BLLOKU I TË DHËNAVE TË KODUARA ..... 1XX - 1
100 Të dhënat e përgjithshme për përpunimin ..... 100 - 1
101 Gjuha e entitetit ..... 101 - 1
102 Kombësia e entitetit ..... 102 - 1
106 Përdorimi i pikëqasjes si emërtim lëndor ..... 106 - 1
120 Të dhënat e koduara për emrin vetjak ..... 120 - 1
123 Të dhënat e koduara për emrin gjeografik ..... 123 - 1
128 Të dhënat e koduara për formën e veprës muzikore dhe tonalitetin ..... 128 - 1
150 Të dhënat e koduara për emrin e organizatës ..... 150 - 1
152 Rregullat ..... 152 - 1
154 Të dhënat e koduara për titullin ..... 154 - 1
160 Kodi për zonën gjeografike ..... 160 - 1
180 Të dhënat e koduara për formën, zhanrin ose karakteristikat fizike ..... 180 - 1
190 Data e lindjes/fillimit/krijimit* ..... 190 - 1
191 Data e vdekjes/ndërprerjes/përfundimit* ..... 191 - 1
192 Nënlloji i entitetit* ..... 192 - 1

NËNFUSHAT E KONTROLLIT ..... NËNFUSHAT E KONTROLLIT - 1
Nënfusha 2 – Kodi i sistemit ..... Nënfusha 2 - 1
Nënfusha 3 – Numri i regjistrimit ..... Nënfusha 3 - 1
Nënfusha 5 – Kodi për marrëdhënien ..... Nënfusha 5 - 1
Nënfusha 7 – Shkrimi i pjesës kryesore të pikëqasjes ..... Nënfusha 7 - 1
Nënfusha 8 – Gjuha e katalogimit ..... Nënfusha 8 - 1
Nënfusha 9 – Gjuha e pjesës kryesore të pikëqasjes ..... Nënfusha 9 - 1

PËRCAKTUESIT ..... PËRCAKTUESIT - 1
Nënfusha j – Përcaktuesi i formës ..... Nënfusha j - 1
Nënfusha x – Përcaktuesi i përgjithshëm ..... Nënfusha x - 1
Nënfusha y – Përcaktuesi gjeografik ..... Nënfusha y - 1

Nënfusha z – Përcaktuesi kohor ..... Nënfusha z - 1

2XX BLLOKU I PIKËQASJEVE TË NJËSUARA ..... 2XX - 1
200 Pikëqasja e njësuar – emër vetjak ..... 200 - 1
210 Pikëqasja e njësuar – emër organizate ..... 210 - 1
215 Pikëqasja e njësuar – emër i njësisë politike-territoriale ose emër gjeografik ..... 215 - 1
220 Pikëqasja e njësuar – emër familje ..... 220 - 1
230 Pikëqasja e njësuar – titull ..... 230 - 1
240 Pikëqasja e njësuar – emër/titull ..... 240 - 1
243 Pikëqasja e njësuar – emër/titull konvencional për tekstet ligjore dhe fetare ..... 243 - 1
250 Pikëqasja e njësuar – emër i përgjithshëm ..... 250 - 1
280 Pikëqasja e njësuar – forma, zhanri ose karakteristikat fizike ..... 280 - 1

3XX BLLOKU I SHËNIMEVE ..... 3XX - 1
300 Shënimi informues ..... 300 - 1
305 Shënimi referues në formë teksti "shih edhe" ..... 305 - 1
310 Shënimi referues në formë teksti "shih" ..... 310 - 1
320 Shënimi me referimin e përgjithshëm shpjegues ..... 320 - 1
330 Shënimi i përgjithshëm për qëllimin ..... 330 - 1
340 Shënimi për biografinë dhe veprimtarinë ..... 340 - 1
356 Shënimi gjeografik ..... 356 - 1

4XX BLLOKU I VARIANTEVE TË PIKËQASJEVE ..... 4XX - 1
400 Varianti i pikëqasjes – emër vetjak ..... 400 - 1
410 Varianti i pikëqasjes – emër organizate ..... 410 - 1
415 Varianti i pikëqasjes – emër i njësisë politike-territoriale ose emër gjeografik ..... 415 - 1
420 Varianti i pikëqasjes – emër familje ..... 420 - 1
430 Varianti i pikëqasjes – titull ..... 430 - 1
440 Varianti i pikëqasjes – emër/titull ..... 440 - 1
443 Varianti i pikëqasjes – emër/titull konvencional për tekstet ligjore dhe fetare ..... 443 - 1
450 Variant i pikëqasjes – emër i përgjithshëm ..... 450 - 1
480 Varianti i pikëqasjes – forma, zhanri ose karakteristikat fizike ..... 480 - 1

5XX BLLOKU I PIKËQASJEVE NË LIDHSHMËRI ..... 5XX - 1
500 Pikëqasja në lidhshmëri – emër vetjak ..... 500 - 1
510 Pikëqasja në lidhshmëri – emër organizate ..... 510 - 1
515 Pikëqasja në lidhshmëri – emër i njësisë politike-territoriale ose emër gjeografik ..... 515 - 1
520 Pikëqasja në lidhshmëri – emër familje ..... 520 - 1
530 Pikëqasja në lidhshmëri – titull ..... 530 - 1
540 Pikëqasja në lidhshmëri – emër/titull ..... 540 - 1
543 Pikëqasja në lidhshmëri – emër/titull konvencional për tekstet ligjore dhe fetare ..... 543 - 1
550 Pikëqasja në lidhshmëri – emër i përgjithshëm ..... 550 - 1
580 Pikëqasja në lidhshmëri – forma, zhanri ose karakteristikat fizike ..... 580 - 1

6XX BLLOKU I NUMRIT TË KLASIFIKIMIT ..... 6XX - 1
675 Klasifikimi Dhjetor Universal (KDU) ..... 675 - 1
686 Klasifikime të tjera ..... 686 - 1

7XX BLLOKU I PIKËQASJEVE TË NJËSUARA NË GJUHËT DHE/APO SHKRIMET E TJERA ..... 7XX - 1
700 Pikëqasja e njësuar në gjuhë dhe/apo shkrim tjetër – emër vetjak ..... 700 - 1
710 Pikëqasja e njësuar në gjuhë dhe/apo shkrim tjetër – emër organizate ..... 710 - 1

 © IZUM, shtator 2023, përkthimi në gjuhën shqipe: nëntor 2023

715 Pikëqasja e njësuar në gjuhën dhe/ose shkrimin tjetër – emër i njësisë politike-territoriale ose emër gjeografik ..... 715 - 1
720 Pikëqasja e njësuar në gjuhë dhe/apo shkrim tjetër – emër familje ..... 720 - 1
730 Pikëqasja e njësuar në gjuhë dhe/apo shkrim tjetër – titull ..... 730 - 1
740 Pikëqasja e njësuar në gjuhë dhe/apo shkrim tjetër – emër/titull ..... 740 - 1
743 Pikëqasja e njësuar në gjuhë dhe/apo shkrim tjetër – emër/titull konvecional për tekstet ligjore dhe fetare ..... 743 - 1
750 Pikëqasja e njësuar në gjuhë dhe/apo shkrim tjetër – emër i përgjithshëm ..... 750 - 1
780 Pikëqasja në lidhshmëri në gjuhën dhe/ose shkrimin tjetër – forma, zhanri ose karakteristikat fizike ..... 780 - 1

8XX BLLOKU I INFORMACIONIT PËR BURIMIN E TË DHËNAVE ..... 8XX - 1
801 Origjina e regjistrimit ..... 801 - 1
810 E dhëna është në ..... 810 - 1
815 E dhëna nuk është në ..... 815 - 1
820 Të dhënat për përdorimin ose qëllimin ..... 820 - 1
830 Shënime të përgjithshme të kataloguesit ..... 830 - 1
835 Të dhënat për pikëqasjen e fshirë ..... 835 - 1
836 Të dhënat për pikëqasjen e zëvendësuar ..... 836 - 1
856 Vendndodhja elektronike dhe qasja ..... 856 - 1

9XX BLLOKU I PËRDORIMIT KOMBËTAR ..... 9XX - 1
911 Burimi i emrit* ..... 911 - 1
915 Varianti i palidhur i pikëqasjes – emër vetjak** ..... 915 - 1
916 Shënimi për konvertimin* ..... 916 - 1
950 Pikëqasja në lidhshmëri e palidhur* ..... 950 - 1
990 Rilidhjet* ..... 990 - 1
991 Shënimi i redaktorit* ..... 991 - 1
992 Fusha për nevojat lokale* ..... 992 - 1

Shtojcat

A LISTA E FUSHAVE/NËNFUSHAVE
A.1 Regjistrimet e njësuara (CONOR) ..... Shtojca A.1 - 1
A.2 Regjistrimet SGC ..... Shtojca A.2 - 1

B LISTA E KODEVE PËR ZONAT GJEOGRAFIKE
B.1 Lista alfabetike e emrave ..... Shtojca B.1 - 1
B.2 Lista alfabetike e kodeve ..... Shtojca B.2 - 1

C INDEKSET PËR KËRKIM
C.1 Regjistrimet e njësuara (CONOR) ..... Shtojca C.1 - 1
C.2 Regjistrimet e njësuara (SGC) ..... Shtojca C.2 - 1

HYRJE

TË PËRGJITHSHME

COMARC/A, formati i lexueshëm nga makina për përshkrimin dhe shkëmbimin e të dhënave të njësuara në sistemin COBISS, bazohet në formatin për të dhënat e njësuara UNIMARC/A. Ky i fundit përfaqëson një standard ndërkombëtar që zhvillohet në kuadër të programit të IFLA-s UNIMARC Core Activity (UCA).

Përveç formatit COMARC/A, në sistemin COBISS përdoret edhe formati për të dhënat bibliografike COMARC/B dhe formati për koleksionet e bibliotekës COMARC/H, të cilët mbështesin funksionet e katalogut të përbashkët dhe katalogëve lokalë si dhe funksionet e udhëheqjes së bibliografive. Për të dy formatet ekzistojnë manuale të veçanta.

Për përgatitjen e manualit *COMARC/A* është përdorur si model manuali *COMARC/B*. Mbi të gjitha përfshinë fushat dhe nënfushat e formatit UNIMARC/A, ndërsa janë shtuar edhe disa karakteristika të veçanta në strukturën e regjistrimeve të njësuara në sistemin COBISS. Përditësimi i manualit bëhet paralelisht me zhvillimin e kontrollit të njësuar në sistemin COBISS.

Teksti i manualit bazohet në botimin *UNIMARC/Të dhënat e njësuara* (Instituti i Shkencave të Informacionit, Maribor 1994), i cili është përkthim i botimit *UNIMARC/Authorities* i vitit 1991, ndërsa janë respektuar edhe disa përditësime nga botimet e mëvonshme *UNIMARC/Authorities*.

Për momentin janë të përfshira përshkrimet e atyre fushave dhe nënfushave që kanë të bëjnë me kontrollin e njësuar të autorëve dhe emërtimeve lëndore nga Lista e përgjithshme e emërtimeve lëndore COBISS (SGC). Në manual nuk janë përfshirë udhëzimet dhe shembujt që nuk janë të lidhur me kontrollin e njësuar në sistemet COBISS. Përjashtim përmbën kapitulli *Hyrje*, *Përkufizimet* dhe *Udhëzime për përdorim*, në të cilat janë përfshirë edhe mundësitë nga UNIMARC/Authorities, të cilat në sistemet COBISS nuk përdoren.

Fushat dhe nënfushat që ndodhen vetëm në formatin COMARC/A, dhe jo në formatin UNIMARC/A, kanë simbolin "*".

Formati COMARC/A është përshtatur me sistemin e katalogimit të përbashkët, i cili është përshkruar në manualin *COBISS3/Katalogimi*. Formati COMARC/A përdoret në bazën e të dhënave CONOR dhe SGC.

Për ndihmë në procesin e përpunimit të materialeve, në kuadër të sistemit të katalogimit të përbashkët, janë përgatitur maskat për shënimin e të dhënave, të cilat përmbajnë fushat dhe nënfushat që përdoren më së shpeshti për krijimin e regjistrimeve të njësuara. Të gjitha fushat e tjera mund të përdoren vetëm nëse janë të parapara në modelin e direktorisë së maskës së caktuar. Në bazën e të dhënave CONOR ndodhet maska PN – emra vetjakë dhe CB – organizata, ndërsa në bazën e të dhënave SGC ndodhen këto maska: PN – emra vetjakë, CB – organizata, GN – emra gjeografikë, FN – emra të familjes, UT – tituj, NT – emër/titull, ET – emër/titull konvencional për tekstet ligjore dhe fetare, TN – emra të përgjithshëm, FS – format, zhanret ose karakteristikat fizike, CBR – organizata (regjistrimet referuese), GNR – emra gjeografikë (regjistrimet

referuese), TNR – emra të përgjithshëm (regjistrimet referuese), FSR – format, zhanret ose karakteristikat fizike (regjistrimet referuese) dhe GER – regjistrimet e përgjithshme shpjeguese.

Në fillim të përshkrimit të një fushe të caktuar është paraqitur lista e nënfushave me shenjën e përsëritshmërisë (r) ose (nr).

Shenjat e pikësimit midis nënfushave nuk është e nevojshme të vendosen, sepse ato shfaqen në mënyrë automatike.

Në manual paraqiten dy lloj shembujsh. Shembujt që nuk kanë asnjë shenjë janë marrë nga manuali UNIMARC Manual. Authorities Format. Ata janë përgatitur sipas rregullave të ndryshme të katalogimit dhe në gjuhë të ndryshme si dhe nuk përshtaten gjithmonë me praktikën tonë. Simbolin "*" e kanë shembujt e shtuar sllovenë dhe shembujt nga bibliotekat e tjera të përfshira në rrjetin COBISS.net. Këta të fundit kanë edhe shenjën COBISS.net.

Në zhvillimin e formatit COMARC/A bashkëpunojnë ekspertë nga institucione të ndryshme dhe për këtë i falenderojmë në mënyrë të veçantë.

Lusim, të gjithë përdoruesit e këtij manuali, që me sugjerimet e tyre të ndihmojnë në përmirësimin e zgjidhjeve të realizuara deri tani.

PËRKUFIZIME

Termet e paraqitura në vazhdim të këtij manuali përdoren në kuptimin e veçantë; termet që përdoren në kuptimin e zakonshëm bibliografik nuk janë përcaktuar. Lista më e plotë e përkufizimeve, që kanë të bëjnë me regjistrimet e njësuara, ndodhet në botimet *Guidelines for Authority and Reference Records (GARR), Guidelines for Subject Authority and Reference Entries (GSARE), Functional Requirements for Authority Data (FRAD) in Statement of International Cataloguing Principles (ICP)*.

Llojet e regjistrimeve

Regjistrim i njësuar – Regjistrimi në formën e lexueshme nga kompjuteri, elementi hyrës i të cilit është pikëqasja e njësuar për personin, organizatën, veprën, markën, emblemën e botuesit/shtypshkronjës, emrin e përgjithshëm, vendin apo formën, zhanrin ose karakteristikat fizike, siç e përcakton institucioni katalogues. Përveç pikëqasjes së njësuar regjistrimi përmban edhe shënimet, të gjitha variantet e pikëqasjes dhe pikëqasjet në lidhshmëri, nga të cilat janë ndërtuar referimet, pikëqasjet e njësuara në gjuhë ose shkrim tjetër, klasifikimin dhe informacionin për historinë e entitetit, shënimet për burimet e përdorura etj. si dhe identifikimin e institucionit katalogues që është përgjegjëse për vendosejen e të dhënave.

Regjistrim i përgjithshëm shpjegues – Regjistrimi në formën e lexueshme nga kompjuteri, elementi hyrës i të cilit është forma e zakonshme e shkurtuar ose ndryshe e stilizuar, e cila udhëzon përdoruesin drejt klasës së përgjithshme apo drejt llojit të caktuar të pikëqasjes. Regjistrimi i tillë shërben për të informuar përdoruesin e listës, katalogut, bibliografisë etj. me rregullat që përdoren në përgjithësi ose për llojin e veçantë të pikëqasjes, si dhe me udhëzimet për kërkimin e pikëqasjeve të tilla.

Regjistrim referues – Regjistrimi në formën e lexueshme nga kompjuteri, elementi hyrës i të cilit është varianti i pikëqasjes. Përdoruesin e listës, katalogut, bibliografisë etj. e drejton nga varianti i pikëqasjes drejt pikëqasjes përkatëse të njësuar (kjo është referimi "shih"). Regjistrimet referuese janë të përcaktuara vetëm për variantet e pikëqasjes, sepse referimet nga pikëqasjet e njësuara në pikëqasjet e njësuara në lidhshmëri (këto janë referimet "shih edhe") gjithmonë mund të krijohen nga regjistrimet e njësuara.

 © IZUM, mars 2022, përkthimi në gjuhën shqipe: prill 2022

Llojet e pikëqasjeve

Pikëqasja

1. Elementi hyrës i regjistrimit (skedës), që përdoret si elementi kryesor për klasifikim, kur renditja është alfabetike. Shih edhe **pikëqasja e njësuar, pikëqasja referuese dhe pikëqasja e përgjithshme shpjeguese**.
2. Fjala "pikëqasja" mund të përdoret edhe në termet, siç është "pikëqasja e njësuar", "varianti i pikëqasjes" etj., që të shpjegohet statusi i një elementi në marrëdhënie me elementet e tjera të ngjashme. Në shembuj të tillë ajo përdoret pavarësisht nga funksionet që ka në regjistrimin e njësuar apo referues. Shih edhe **pikëqasja e njësuar, pikëqasja e njësuar në gjuhë ose shkrim tjetër, pikëqasja në lidhshmëri, varianti i pikëqasjes dhe pikëqasja në shkrim alternativ**.
3. Termet, siç është "pikëqasja për emrin e organizatës", "pikëqasja për emrin vetjak" dhe "pikëqasja për titullin", mund të përdoren për të treguar llojin e pikëqasjes bazuar në llojin e emrit ose titullit, në të cilin pikëqasja bazohet, pavarësisht nga funksioni ose marrëdhënia me pikëqasjet e tjera.

Pjesa kryesore e pikëqasjes – Pjesa e pikëqasjes që identifikon emrin e entitetit dhe nuk përmban të dhënat për dallim. P.sh. në pikëqasjen "**a**Nicolini da Sabbio **b**Domenico **f**15-- to 160-? **c**imprimeur-libraire" pjesa kryesore e pikëqasjes "**a**Nicolini da Sabbio **b**Domenico" është në gjuhën italiane. Gjuha e katalogimit është frëngjishtja, për këtë arsye informacioni tjetër shtesë për emrin është shkruar në frëngjisht ("**c**imprimeur-libraire").

Pikëqasja e kontrolluar – Pikëqasja e shënuar në regjistrimin e njësuar. Pikëqasjet e kontrolluara përmbajnë format e njësuara të emrave dhe variantet e emrave.

Pikëqasjet bazuar në funksionin e tyre në regjistrim:

Pikëqasja e njësuar – Pikëqasja për regjistrimin e njësuar.

Pikëqasja referuese – Pikëqasja për regjistrimin referues.

Pikëqasja e përgjithshme shpjeguese – Pikëqasja për regjistrimin e përgjithshëm shpjegues.

Pikëqasjet bazuar në marrëdhëniet me pikëqasjet e tjera:

Pikëqasja e njësuar – Pikëqasja e formuar nga forma e rekomanduar si formë kryesore për përdorim.

Pikëqasja e njësuar në gjuhë ose shkrim tjetër – Forma alternative e pikëqasjes, e cila bazohet në formën e emrit, titullit ose lëndës në gjuhën ose shkrimin tjetër.

Pikëqasja në lidhshmëri – Njëra nga dy ose disa pikëqasje të njësuara për emrin e entiteteve të njëjta ose entiteteve në lidhshmëri, ku secila nga ato është në mënyrë bibliografike e lidhur me njëra-tjetrën.

Varianti i pikëqasjes – Pikëqasja për emrin e entitetit të njëjtë, e cila për nga forma ndryshon nga pikëqasja e njësuar. Zakonisht bazohet në variantin e emrit, të cilin herë pas here e përdor vet personi, organizata ose familja, apo e përdorin të tjerët për identifikimin e këtij personi, organizate, familje, marke, embleme të botuesit/shtypshkronjës ose veprës. Varianti i pikëqasjes mund të formohet sipas një modeli ndryshe nga ai sipas të cilit është përcaktuar pikëqasja e njësuar. Në rastin e pikëqasjes lëndore ky është varianti, i cili nuk është i njëjtë me elementin hyrës të pikëqasjes së njësuar lëndore.

Pikëqasja në shkrimin alternativ – Pikëqasja e njësuar në një shkrim tjetër.

Pjesët përbërëse të regjistrimit

Sistemi referues – Identifikimi në kuadër të regjistrimit të njësuar për variantet e pikëqasjeve ose pikëqasjet në lidhshmëri, prej të cilave duhet të ndërtohet referimi që orienton përdoruesit e listës, katalogut, bibliografisë etj. drejt pikëqasjes së duhur të njësuar. Sistemi referues përdoret për gjenerimin e udhëzimeve dhe si ndihmë për kataloguesin që të përcaktoj më lehtë cilat udhëzime janë krijuar.

Shënimi – Shënimi, i cili në katalogë, bibliografi etj. zakonisht shfaqet nën pikëqasjen e njësuar, referuese ose të përgjithshme shpjeguese dhe shpjegon marrëdhënien midis pikëqasjes dhe pikëqasjeve të tjera, të cilave u referohet.

Entiteti parësor – Entiteti, i cili është shënuar në bllokun 2XX dhe për të cilin është krijuar regjistrimi. Të dhënat në bllokun 1XX zakonisht kanë të bëjnë me karakteristikat e entitetit parësor.

UDHËZIME PËR PËRDORIM

Fushat e detyrueshme

Përveç fushës së sistemit 000, e cila plotësohet në mënyrë automatike, regjistrimi duhet të përmbaj këto fusha:

001 – Etiketa e regjistrimit
100 – Të dhënat e përgjithshme për përpunimin
2XX – Blloku i pikëqasjeve të njësuara

Përsëritshmëria e fushave dhe nënfushave

Nëse fusha apo nënfusha ka shenjën "r", atë fushë apo nënfushë mund ta përsëritni. Shenja "nr" do të thotë që fusha apo nënfusha nuk mund të përsëritet.

Shenjat e pikësimit

Shenjat e pikësimit midis nënfushave, të parapara nga GARR, nuk shënohen sepse ato vendosen në mënyrë atomatike. Shenjat e pikësimit janë: "=" (para pikëqasjes paralele), shenjat "<", ">", "<<" dhe ">>" (në sistemin referues), më pas ";" dhe "," (në zonën e burimit – blloku 8XX). As shenjat e tjera të pikësimit midis nënfushave (në pikëqasje, shënime etj.) nuk shënohen sepse në sistemet COBISS ato vendosen në mënyrë automatike.

Karakteri plotësues

Në regjistrime duhet të vendosen të gjitha të dhënat e nevojshme, mirëpo nganjëherë këto të dhëna nuk janë në dispozicion. Për raste të tilla ekziston karakteri plotësues "|", i cili përdoret kur nuk mund të përcaktohet vlera e treguesit ose e të dhënave të koduara.

Përdorimi i formatit

Regjistrimet e njësuara

Ky format, parasegjithash, përdoret për shkëmbimin e regjistrimeve të njësuara për pikëqasjet e njësuara. Këto regjistrime mund të përmbajnë edhe sistemin referues të varianteve të pikëqasjes ose pikëqasjes në lidhshmëri (siç është e përshkruar në GARR, 0.3.1), për të cilat, sipas nevojës, mund të gjenerohen në mënyrë autormatike referimet (nga fushat 4XX gjenerohen variantet e pikëqasjes, ndërsa nga fusha 5XX gjenerohen pikëqasjet në lidhshmëri). Shih shembullin 1, 6 dhe 9.

Në raste të veçanta referimet mund të vendosen në regjistrimet e njësuara në formën e shënimeve: fusha *305 – Shënimi referues në formë teksti "shih edhe"*. Shënimet referuese përdoren kur referimi është shumë i komplikuar për t'u gjeneruar si duhet nga një ose disa pikëqasje në lidhshmëri. Pikëqasjen e njësuar nga fusha 2XX e gjeni edhe në fushat 5XX në regjistrimet e njësuara për pikëqasjen e vendosur në fushën 305. Gjenerimi automatik i pikëqasjeve në lidhshmëri nga këto fusha 5XX zakonisht nuk është i mundur (kodi për përjashtimin e shfaqjes së referimit në nënfushën 5), sepse fusha 305 tashmë përmban referimin. Shih shembullin 2.

 © IZUM, mars 2022, përkthimi në gjuhën shqipe: prill 2022

Regjistrimet referuese

Regjistrimi referues për variantin e pikëqasjes krijohet vetëm kur referimi është shumë i komplikuar për të gjeneruar variantin e duhur të pikëqasjes nga fushat 4XX në regjistrimin e njësuar. Regjistrimi referues përmban variantin e pikëqasjes në fushën 2XX si dhe fushën *310 – Shënimi referues në formë teksti "shih"*. Pikëqasjen nga fusha 2XX e gjeni edhe në fushat 4XX në regjistrimet e njësuara për pikëqasjet e njësuara të vendosura në fushën 310. Gjenerimi automatik i varianteve të pikëqasjes nga këto fusha 4XX zakonisht nuk lejohet (kodi për përjashtimin e shfaqjes së referimit në nënfushën 5), sepse për këtë pikëqasje tashmë ekziston regjistrimi referues. Shih shembullin 3, 10 dhe 11.

Regjistrimet e përgjithshme shpjeguese

Regjistrimet e përgjithshme shpjeguese i krijoni kur keni nevojë për variantet e pikëqasjes nga pikëqasjet shpjeguese. Regjistrimi i përgjithshëm shpjegues përmban pikëqasjen shpjeguese në fushën 2XX dhe shënimin me referimin e përgjithshëm shpjegues në 320. Pikëqasja shpjeguese nga fusha 2XX nuk është në asnjë regjistrim të njësuar. Shih shembullin 4.

Marrëdhëniet midis pikëqasjeve

Të dhënat paralele

Mundësia e parë

Për krijimin e regjistrimit në këtë format vlenë parimi që duhet jetë e vendosur një formë e një pikëqasjeje dhe kjo pikëqasje është e përshtatshme për katalogun në gjuhën e përcaktuar në fushën 100. Shenjat për referim përfaqësojnë strukturën referuese për këtë pikëqasje në këtë katalog.

Për ndërtimin e katalogut paralel në gjuhën tjetër, institucioni i katalogimit mund transferoj format ekuivalente ose paralele të pikëqasjeve nga fusha 2XX, bashkë me shënimet në sistemin referues, të cilat u përshtaten pikëqasjeve paralele. Nuk rekomandohet që shënimet dhe sistemi referues për pikëqasjet paralele, të cilat bazohen në dallimet në gjuhë, të jenë të pranishme në të njëjtën kohë në një regjistrim të njësuar. Pikëqasjet paralele duhet të kenë regjistrime të njësuara të ndara, në të cilat shfaqen si pikëqasje të njësuara, ndërsa struktura e tyre është përshkruar në fushat 4XX, 5XX (variantet e pikëqasjeve dhe pikëqasjet në lidhshmëri) dhe 3XX (shënime).

Pikëqasjet paralele, jo vetëm kur janë në gjuhën tjetër por edhe kur në shkrimin tjetër kodohen sipas rregullave për të dhënat paralele. Kur pikëqasjet janë në shkrim tjetër, mirëpo në gjuhën e njëjtë sikurse fusha e tyre përkatëse, duhet të respektohen rregullat për shkrimet alternative.

Regjisterimet për formulime të ndryshme të pikëqasjes, të krijuara për katalogët në gjuhë të ndryshme, mes vete mund të jenë të lidhura përmes fushave 7XX për pikëqasjet e njësuara në gjuhë ose shkrim tjetër. Në çdo regjistrim të njësuar në fushat 7XX mund të vendoset secila pikëqasje paralele dhe numri përkatës i regjistrimit të saj të njësuar (nënfusha 3). Shih shembullin 7.

Mundësia e dytë

Institucioni trajton format paralele të pikëqasjes së njësuar nga fusha 2XX si variante të zakonshme ose pikëqasje në lidhshmëri në fushat 4XX ose 5XX me simbolin e gjuhës ose pa të. Referimet për formën paralele nuk janë të nevojshme dhe *nuk janë* të përfshira në regjistrim. Përzgjedhja e teknikës varet nga praktika e institucionit katalogues.

Në regjistrimin e dhënë dallohet:
1. gjuha e katalogimit që përdoret për cilësorët në pikëqasjet (2XX), variantet e pikëqasjeve (4XX), pikëqasjet në lidhshmëri (5XX), pikëqasjet e njësuara në gjuhë ose shkrim tjetër (7XX) dhe për shënimet (3XX);

2. gjuha e pjesës kryesore të pikëqasjes, kjo është pjesë e pikëqasjes që identifikon entitetin, mirëpo nuk përmban të dhënat për ndryshimin. P.sh. në pikëqasjen "**a**Nicolini da Sabbio **b**Domenico **f**15-- to 160-? **c**imprimeur-libraire" pjesa kryesore e pikëqasjes është "**a**Nicolini da Sabbio **b**Domenico" në gjuhën italiane. Gjuha e katalogimit është frëngjitshtja, për këtë arsye informacioni shtesë te emri është në frëngjitsht ("**c**imprimeur-libraire").

Të dhënat për shkrimet alternative

Shkrimi i katalogimit (pikëqasja, shënimi, sistemi referues etj.) në regjistrim është i përcaktuar në fushën 100. Disa institucione kanë nevojë për pikëqasje, shënime dhe sistem referues në disa shkrime, për shkak të transliterimit dhe rregullave të drejtshkrimit për shkrimet e tjera që përdoren për gjuhën e caktuar (p.sh. cirilik dhe latin). Format e pikëqasjeve, shënimet dhe sistemet referuese në shkrimet alternative mund të jenë njëkohësisht të pranishme në të njëjtin regjistrim të njësuar ose në regjistrime të ndara, që janë të lidhur mes vete. Kur format në shkrimet alternative ndryshojnë nga pikëqasjet përkatëse edhe në gjuhë, vlejnë rregullat për të dhënat paralele.

Kur format e pikëqasjeve në shkrimet alternative janë të pranishme në të njëjtin regjistrim, regjistrohen si fusha të përsëritshme 2XX me nënfushë 7 – *Shkrimi i pjesës kryesore të pikëqasjes*. Format e shënimeve ose sistemeve referuese në shkrimin alternativ vendosen në blloqet përkatëse si fusha të përsëritshme. Shih shembullin 8.

Kur format në shkrimet alternative janë prezente në regjistrimet e ndara, regjistrimet janë të lidhura përmes fushave 7XX për pikëqasjet e njësuara, të cilat përmbajnë formën nga fusha 2XX në shkrim alternativ. Fusha 7XX përmban nënfushën 7 – *Shkrimi i pjesës kryesore të pikëqasjes*. Në fushën 7XX mund të vendoset edhe numri i regjistrimit të njësuar për pikëqasjen në shkrimin alternativ.

Të dhënat e gjeneruara sipas rregullave të tjera

Për formimin e pikëqasjeve në regjistrimin e njësuar vlenë parimi, që forma e saj është e kontrolluar ose me rregullat e përshkruara të katalogimit ose me rregullat e klasifikimit lëndor, të vendosura në fushën *152 – Rregullat*. Mirëpo, për shkak të arsyeve të ndryshme katalogu përmban pikëqasjet ose komplet regjistrimet e njësuara, të përcaktuara sipas sistemeve të ndryshme të rregullave. Kur këto pikëqasje ose regjistrime të njësuara kanë të bëjnë me entitetin e njëjtë, duhet të përcaktohet marrëdhënia midis tyre.

Disa institucione vendosin pikëqasjet e formuara sipas rregullave të tjera, në regjistrimin e njëjtë të njësuar, ose ato i vendosin në regjistrimet e ndara, të cilat mes tyre janë të lidhura me komplet strukturën e regjistrimeve të njësuara (p.sh. pikëqasjet me përparësi, variantet e pikëqasjeve, shënimet, informacionet për burimet e të dhënave). Kur në regjistrimin e njëjtë ndodhen të dhënat sipas rregullave të ndryshme, format e përcaktuara sipas rregullave të tjera nga pikëqasja në fushën 2XX, vendosen si variante të pikëqasjes në fushat e përsëritshme 4XX, ndërsa marrëdhënia shpjegohet përmes kodit "n" në nënfushën 5 – *Kodi për marrëdhënien*. Kur të dhënat sipas rregullave të ndryshme janë në regjistrime të ndryshme të njësuara, format e tjera të pikëqasjes nga fusha 2XX vendosen si pikëqasje në lidhshmëri në fushën 5XX, me nënfushën 5 – *Kodi për marrëdhënien* për sqarimin e marrëdhënies. Shih shembullin 5 dhe 12.

SHEMBUJ

1.

210	02	**a**Pittsburgh Research Center
410	01	**a**United States **b**Bureau of Mines **b**Pittsburgh Research Center
510	02	**5**a **a**Pittsburgh Mining and Safety Research Center Center *(Regjistrim i njësuar me pikëqasje të njësuar në fushën 210. Në fushën 410 është varianti i pikëqasjes nga sistemi referues i varianteve të pikëqasjes, ndërsa në fushën 510 pikëqasja në lidhshmëri nga sistemi referues i pikëqasjeve në lidhshmëri.)*

 © IZUM, mars 2022, përkthimi në gjuhën shqipe: prill 2022

2.

200	␣1	**a**Japp **b**Alexander H.
305	0␣	**a**For works of this author written under pseudonyms, see also **b**Gray, E. Condor **a**and **b**Page, H.A. *(Regjistrim i njësuar me referimin në formë teksti "shih edhe" në fushën 305.)*

200	␣1	**a**Gray **b**E. Condor
500	␣1	**5**z0 **a**Japp **b**Alexander H. *(Regjistrim i njësuar me pikëqasjen në lidhshmëri nga sistemi referues i pikëqasjeve në lidhshmëri, i cili në fushën 500 ka kodin për përjashtimin e shfaqjes së referimeve.)*

200	␣1	**a**Page **b**H.A.
500	␣1	**5**z0 **a**Japp **b**Alexander H. *(Regjistrim i njësuar me pikëqasjen e njësuar nga sistemi referues i pikëqasjeve në lidhshmëri, i cili në fushën 500 ka kodin për përjashtimin e shfaqjes së referimeve.)*

3.

200	␣1	**a**Kacew **b**Romain
310	0␣	**a**Écrit sous deux pseudonymes **b**Ajar, Émile **b**Gary, Romain *(Regjistrim referues me variantin e pikëqasjes si pikëqasje referuese në fushën 200 dhe me referimin në formë teksti "shih" në fushën 310.)*

200	␣1	**a**Ajar **b**Émile
400	␣1	**5**z0 **a**Kacew **b**Romain *(Regjistrim i njësuar me variantin e pikëqasjes nga sistemi referues i varianteve të pikëqasjes, i cili në fushën 400 ka kodin për përjashtim nga shfaqja e referimit.)*

200	␣1	**a**Gary **b**Romain
400	␣1	**5**z0 **a**Kacew **b**Romain *(Regjistrim i njësuar me variantin e pikëqasjes nga sistemi referues i varianteve të pikëqasjes, i cili në fushën 400 ka kodin për përjashtim nga shfaqja e referimit.)*

4.

210	12	**a**Conference…
320	␣␣	**a**Conference proceedings are entered under the name of the conference, etc., or the title of the publication if the conference, etc., lacks a name. Thus, see also: Symposium..., Workshop..., etc., *(Regjistrim i përgjithshëm shpjegues me pikëqasje shpjeguese në fushën 210 dhe shënim me referimin e përgjithshëm shpjegues në fushën 320.)*

5.

152	␣␣	**a**PPIAK
200	␣1	**a**Mirković **b**Mijo
400	␣1	**5**e **a**Balota **b**Mate
500	␣1	**2**uni-PPIAK **5**n **5**f **a**Mirković **b**Mijo
500	␣1	**2**uni-PPIAK **5**n **5**e **a**Balota **b**Mate

		(Sipas rregullave kroate për implementimin e PPIAK *në katalogun online me formatin* UNIMARC *për regjistrimet e njësuara emri Mijo Mirković dhe pseudonimi Mate Balota janë trajtuar si pikëqasje në lidhshmëri. Pseudonimi Mate Balota në* PPIAK *është trajtuar si variant i pikëqasjes.)*

6. * COBISS.net

210	02	**a**Universiteti i Prishtinës **b**Fakulteti i Arkitekturës
510	02	**3**<nnn> **5**a **a**Universiteti i Prishtinës **b**Fakulteti i Arkitekturës, Ndërtimit dhe Gjeoezisë

7. * COBISS.net

200	␣1	**7**cb **a**Фром **b**Ерих **f**1900-1980
200	␣1	**7**ba **a**Fromm **b**Erich **f**1900-1980
		(Në sistemin COBISS.SR kanë katalog në shkrim cirilik dhe latin, për këtë arsye regjistrimet e njësuara përmbajnë dy fusha 200. Në fushën e parë është emri në shkrim cirilik, ndërsa në fushën e dytë në shkrim latin. Fushat përmbajnë nënfushën 7, e cila tregon shkrimin e pjesës kryesore të pikëqasjes.)

8. * COBISS.net

200	␣1	**7**cb **a**Нушић **b**Бранислав **f**1864-1938
200	␣1	**7**ba **a**Nusic **b**Branislav **f**1864-1938
700	␣1	**3**357 **7**ca **9**bul **a**Нушич **b**Бранислав **f**1864-1938

200	␣1	**7**ca **9**bul **a**Нушич **b**Бранислав **f**1864-1938
700	␣1	**3**613 **7**cb **a**Нушић **b**Бранислав **f**1864-1938
700	␣1	**3**613 **7**ba **a**Nusic **b**Branislav **f**1864-1938
		(Në sistemin COBISS.BG për emrat vetjakë përdorin tri pikëqasje të njësuara. Në regjistrimin e parë janë pikëqasjet në shkrimet alternative, forma origjinale e emrit në shkrim cirilik dhe forma e transliteruar në shkrim latin. Në regjistrimin e dytë është emri në gjuhën bullgare. Regjistrimet janë të lidhura përmes fushës 700.)

9. * COBISS.net

250	␣␣	**a**Ornitologjia
450	␣␣	**a**Studiuesit e zogjve
550	␣␣	**5**g **a**Zoologjia
550	␣␣	**5**z **a**Ornitologjia
		(Regjistrim i njësuar me pikëqasjen e njësuar në fushën 250. Në fushën 450 është varianti i pikëqasjes, ndërsa në fushat 550 janë pikëqasjet në lidhshmëri.)

10. * COBISS.net

215	␣␣	**a**Perandoria Osmane **z**shekulli 19
310	1␣	**a**Është i nevojshëm kombinimi **b**Perandoria Osmane **a**+ **b**Historia **a**+ **b**1800-1899
		(Regjistrim referues me pikëqasjen referuese në fushën 215 dhe shënimin referues në fushën 310, i cili ju udhëzon drejt pikëqasjes përkatëse të njësuar. Regjistrimet e njësuara nuk përdoren për përcaktuesit kohorë)

215	␣␣	**a**Perandoria Osmane
		(Regjistrim i njësuar për pikëqasjen e njësuar nga fusha 310 në regjistrimin e parë.)

 © IZUM, mars 2022, përkthimi në gjuhën shqipe: prill 2022

250	␣␣	**a**Historia *(Regjistrim i njësuar për pikëqasjen e njësuar nga fusha 310 në regjistrimin e parë.)*

11. * COBISS.net

250	␣␣	**a**Balada amerikane
310	1␣	**a**Është i nevojshëm kombinimi **b**Baladat angleze **a**+ **b**Shtetet e Bashkuara të Amerikës *(Regjistrim referues me pikëqasjen referuese në fushën 250 dhe shënimin referues në fushën 310, i cili ju udhëzon drejt pikëqasjeve përkatëse të njësuara.)*

250	␣␣	**a**Baladat angleze *(Regjistrim i njësuar për pikëqasjen e njësuar nga fusha 310 në regjistrimin e parë.)*

215	␣␣	**a**Shtetet e Bashkuara të Amerikës *(Regjistrim i njësuar për pikëqasjen e njësuar nga fusha 310 në regjistrimin e parë.)*

12. *

152	␣␣	**b**sgc
250	␣␣	**a**Pust
450	␣␣	**2**lc **3**sh 85020377 **5**n **8**eng **a**Carnival
450	␣␣	**2**ram **3**FRBNF11936675 **5**n **8**fre **a**Carnavals
450	␣␣	**2**sears **3**SSEA93000244 **5**n **8**eng **a**Carnival *(Në fushat 450 ndodhet pikëqasja për termin nga fusha 250, e formuar sipas rregullave LCSH, RAMEAU dhe SEARS. Nga kodet në nënfushën 5 kuptohet se bëhet fjalë për pikëqasjen e formuar sipas rregullave të tjera.)*

Pasqyra e përmbajtjes së regjistrimeve

Përmbajtja e regjistrimit		Zona, siç është e përcaktuar në GARR
E pranishme në të gjitha llojet e regjistrimeve:		
0XX	Blloku i identifikimit	Zona ISADN (ku përdoret)
1XX	Blloku i të dhënave të koduara	
8XX	Blloku i informacionit për burimin e të dhënave	Zona e shënimeve të kataloguesit, Zona e burimit
Regjistrimi i njësuar (lloji i regjistrimit = x):		
2XX	Blloku i pikëqasjeve të njësuara (pikëqasja e njësuar)	Zona e pikëqasjeve të njësuara
300	Shënimi informues	Zona e shënimeve informuese
305	Shënimi referues në formë teksti "shih edhe"	
4XX	Blloku i varianteve të pikëqasjeve	Zona e sistemit referues të varianteve të pikëqasjes
5XX	Blloku i pikëqasjeve në lidhshmëri	Zona e sistemit referues të pikëqasjeve në lidhshmëri
7XX	Blloku i pikëqasjeve të njësuara në gjuhët dhe/apo shkrimet e tjera	Zona e emërtimit të njësuar
Regjistrimi referues (lloji i regjistrimit = y):		

2XX	Blloku i pikëqasjeve të njësuara (varianti i pikëqasjes)	Zona e pikëqasjeve referuese
300	Shënimi informues	Zona e shënimeve informuese
310	Shënimi referues në formë teksti "shih"	Zona e emërtimit uniform
7XX	Blloku i pikëqasjeve të njësuara në gjuhët dhe/apo shkrimet e tjera	Zona e emërtimit referues
Regjistrimi i përgjithshëm orientues (lloji i regjistrimit = z):		
2XX	Blloku i regjistrimeve të njësuara (pikëqasja shpjeguese)	Zona e emërtimit shpjegues
320	Shënimi me referimin e përgjithshëm shpjegues	Zona e shënimeve informuese
7XX	Blloku i pikëqasjeve të njësuara në gjuhët dhe/apo shkrimet e tjera	Zona e emërtimit shpjegues

Përputhshmëria midis COMARC/A dhe COMARC/B

Fushat për pikëqasjen në COMARC/A		Përdorimi i pikëqasjeve në fushat COMARC/B
200	Emër vetjak	700, 701, 702 4XX me fushat e fiksuara 700, 701, 702 600
210	Emër organizate	710, 711, 712 4XX me fushat e fiksuara 710, 711 601
215	Emër gjeografik	710, 711, 712 4XX me fushat e fiksuara 710, 711 607
220	Emër familje	602
230	Titull	500 4XX me fushat e fiksuara 500 605
240	Emër/titull	604
243	Emër/titull konvencional për tekstet ligjore dhe fetare	604
250	Emër i përgjithshëm	606, 608
280	Forma, zhanri ose karakteristikat fizike	606, 609

Shfaqja e regjistrimeve referuese dhe atyre të njësuara

Për kodimin e të dhënave, për shfaqje më fleksibël të regjistrimeve referuese dhe atyre të njësuara, ashtu siç lejon GARR, përdoren këto metoda:

1. Sistemet referuese janë të ndara në fushat 4XX për variantet e pikëqasjeve dhe fushat 5XX për pikëqasjet në lidhshmëri. Në këtë mënyrë karakteri i parë i shenjës së këtyre fushave tregon se në shfaqjen e referimeve duhet të përdoret simboli ">" ose simboli ">>". Ndërsa në shfaqjen e regjistrimeve të njësuara, shenjat e fushave 4XX dhe 5XX kërkojnë përdorimin e simbolit "<" dhe "<<" ose referimin *shih* dhe *shih edhe*.

 © IZUM, mars 2022, përkthimi në gjuhën shqipe: prill 2022

2. Në fushë mund të përdoret nënfusha 5 – *Kodi për marrëdhënien*, në mënyrë që në formë të koduar të vendosur një nga shumë standardet e mundshme të marrëdhënieve midis sistemit referues dhe pikëqasjes në fushën 2XX. Këto kode u mundësojnë sistemeve shfaqjen e të dhënave për marrëdhëniet specifike në regjistrimet referuese dhe atyre të njësuara. Për shkak se teksti i gjeneruar në bazë të kodit varet nga sistemi, marrëdhënia specifike ose referimi mund të shprehen në gjuhë, të cilën e përzgjedh përdoruesi. E dhëna për marrëdhënien apo referimi shfaqen bashkë me simbolet ">", ">>", "<" dhe "<<" jo në vend të tyre.
3. Nëse marrëdhënia midis pikëqasjes në fushën 2XX dhe sistemit të referimit nuk është njëra nga ato, për të cilat parashihen vlerat e kodit për marrëdhënien në nënfushën 5, mirëpo ende bëhet fjalë për marrëdhënien njëra kundër tjetrës, për vendosjen e udhëzimeve është paraparë nënfusha *0 – Udhëzimi*. Për shkak se udhëzimi është në formë teksti, institucionet që të dhënën në atë gjuhë nuk mund ta përdorin, atë gjatë shfaqjes së regjistrimeve të njësuara apo atyre referuese mund të mos e vendosin, sepse nga shenja e fushës gjenerohen edhe shenjat më të pasakta ">", ">>", "<" dhe "<<". Nëse në nënfushën 5, përveç kodit për marrëdhënien shfaqet edhe nënfusha 0, udhëzimi nga nënfusha 0 është më i përshtatshëm për shfaqje, përveç nëse kjo nuk është e dëshirueshme për shkak të gjuhës ose arsyeve të tjera.
4. Nëse marrëdhënia midis referimit dhe pikëqasjes është disa kundër një ose marrëdhënia është në ndonjë mënyrë tjetër e komplikuar, që e bën të dëshirueshme për transferimin e udhëzimit (përveç sistemit referues) edhe në formën e shënimit, mund të përdoren shënimet në fushat 3XX. Variantet e pikëqasjes, të cilave u referoheni dhe pikëqasjet me përparësi, të cilave u referoheni në shënime, duhet të shfaqen edhe në regjistrimet e njësuara në formën e sistemit referues. Kjo u mundëson institucioneve, të cilat nuk mund të përdorin shënimet, të shfaqin të dhënat referuese nga sistemi i referimit bazuar në fushat 4XX dhe 5XX.

0XX BLLOKU I IDENTIFIKIMIT

LISTA E FUSHAVE

001 Etiketa e regjistrimit
010 Identifikuesi Standard Ndërkombëtar i Emrave (ISNI)
017 Identifikues të tjerë
035 Numrat e kontrollit të regjistrimeve në sistemet e tjera

Ky bllok përmban të dhënat që identifikojnë regjistrimin ose entitetin e përshkruar në regjistrim. Fusha 001 është e detyrueshme në çdo regjistrim.

001 ETIKETA E REGJISTRIMIT

Fusha përmban të dhënat e përgjithshme, të cilat janë të nevojshme për krijimin e regjistrimit.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
001		Etiketa e regjistrimit	nr
	a	*Statusi i regjistrimit*	nr
	b	*Lloji i regjistrimit*	nr
	c	*Lloji i entitetit*	nr
	g	*Kodi i plotësisë së regjistrimit*	nr
	x	*Numri i regjistrimit zëvendësues**	nr

Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

001a Statusi i regjistrimit

Kodi tregon gjendjen e regjistrimit dhe është i detyrueshëm.

c	*regjistrim i korigjuar* Kodi përdoret kur regjistrimi është korrigjuar përfundimisht, d.m.th. është pa gabime gramatikore dhe të përmbajtjes (shih shembullin 2).
d	*regjistrim i fshirë* Kodi tregon se regjistrimi nuk është më i vlefshëm. Nëse regjistrimi përzgjidhet për t'u fshirë, në nënfushën 001x duhet të vendoset numri identifikues i regjistrimit të njësuar, i cili përdoret në vend të regjistrimit të fshirë (shih shembullin 3).
n	*regjistrim i ri* Kodi është i paracaktuar për çdo regjistrim të ri (shih shembujt 1, 5, 6, 7).
r	*regjistrim i ndarë* Regjistrimi i pavlefshëm, i cili në nënfushën 001x përmban numrat identifikues të regjistrimeve për entitetet në të cilat është ndarë (shih shembullin 4).

001b Lloji i regjistrimit

Kodi tregon llojin e regjistrimit. Vendosja e kodit është e detyrueshme; vlera e paracaktuar varet nga maska e përzgjedhur e shënimit të të dhënave.

x	*regjistrim i njësuar* Kodi tregon regjistrimin, i cili në fushën 2XX përmban pikëqasjen e njësuar.
y	*regjistrim referues* Kodi tregon regjistrimin, i cili në fushën 2XX përmban variantin e pikëqasjes; ky variant i pikëqasjes në regjistrimet bibliografike nuk shfaqet kurrë si emërtim kryesor. Pikëqasja nga fusha 2XX shfaqet edhe në fushën 4XX në një nga regjistrimet e njësuara.
z	*regjistrim i përgjithshëm shpjegues* Kodi tregon regjistrimin, i cili në fushën 2XX përmban pikëqasjen shpjeguese. Pikëqasjet e tilla nuk ndodhen në asnjë nga fushat 4XX në regjistrimet e njësuara.

001c Lloji i entitetit

Kodi tregon llojin e entitetit, i cili ndodhet në fushën 2XX. Shënimi i kodit është i detyrueshëm; vlera e paracaktuar varet nga maska e përzgjedhur e shënimit të të dhënave.

a	*emër vetjak*
b	*emër organizate*
c	*emër gjeografik*
e	*emër familje*
f	*titull*
h	*emër/titull*
i	*emër/titull përmbledhës*
j	*emër i përgjithshëm*
l	*formë, zhanër ose karakteristika fizike*

001g Kodi i plotësisë së regjistrimit

Kodi tregon shkallën e plotësisë së regjistrimit. Nënfushat nuk plotësohen, nëse regjistrimi është i plotë (përmban të dhënat e nevojshme, përfshirë edhe variantet e pikëqasjeve dhe pikëqasjet në lidhshmëri).

3	*regjistrim i pjesshëm* Regjistrimi nuk është i plotë, sepse ende nuk janë verifikuar përfundimisht të gjitha të dhënat (shih shembujt 1, 5, 6).

001x Numri i regjistrimit zëvendësues*

Nëse në bazën e të dhënave ndodhen disa regjistrime të njësuara për entitetin e njëjtë (dublikatë), duhet të përcaktoheni për regjistrimin që dëshironi ta mbani. Regjistrimet e tjera i përzgjidhni për t'u fshirë (në nënfushën 001a vendoset kodi *"d" – regjistrim i fshirë*). Në regjistrimet e përzgjedhura për t'u fshirë, në nënfushën 001x duhet të vendosni numrin identifikues të regjistrimit zëvendësues (shih shembullin 3).

Nëse regjistrimi i njësuar i përket disa entiteteve të ndryshme me të njëjtin emër, atë mund ta përzgjidhni si regjistrim të ndarë (në nënfushën 001a vendoset kodi *"r" – regjistrim i ndarë*)

 © IZUM, prill 2020, përkthimi në gjuhën shqipe: tetor 2020

dhe për të gjitha entitetet krijoni regjistrime të reja të njësuara. Në regjistrimin me kodin "r" në nënfushën 001x vendosen numrat identifikues të të gjitha regjistrimeve të reja të njësuara (shih shembullin 4).

SHEMBUJ

1. *

001	␣␣	**a**n **b**x **c**a **g**3
200	␣1	**a**Horvat **b**Irena
		(Regjistrim i ri, i pjesshëm.)

2. *

001	␣␣	**a**c **b**x **c**a
200	␣1	**a**Horvat **b**Irena **f**1965-
		(Regjistrim i përmirësuar, i plotë.)

3. * COBISS.net

001	␣␣	**a**d **b**x **c**a **x**<nnn>
200	␣1	**a**Dakaj **b**Mirlinda
		(Regjistrim i përzgjedhur për t'u fshirë. Në nënfushën x është numri identifikues i regjistrimit të njësuar që përdoret në vend të këtij regjistrimi.)

001	␣␣	**a**c **b**x **c**a
200	␣1	**a**Berisha **b**Mirlinda
		(Regjistrimi që mbetet (ID=nnn).)

4. * COBISS.net

001	␣␣	**a**r **b**x **c**a **x**<nnn, mmm>
200	␣1	**a**Bartol **b**Tomas
		(Regjistrim i përzgjedhur si i ndarë. Në nënfushën x janë numrat identifikues të regjistrimeve të reja të njësuara.)

001	␣␣	**a**n **b**x **c**a
200	␣1	**a**Bartol **b**Tomas **f**1962-
		(Regjistrim i ri (ID=nnn).)

001	␣␣	**a**n **b**x **c**a
200	␣1	**a**Bartol **b**Tomas **f**1968-
		(Regjistrim i ri (ID=mmm).)

5. * COBISS.net

001	␣␣	**a**n **b**x **c**j **g**3
250	␣␣	**a**Zhytja e lirë
		(Regjistrim i ri, i pjesshëm.)

6. * COBISS.net

001	␣␣	**a**n **b**x **c**e **g**3
220	␣␣	**a**Jasharët **c**familje fisnikësh

		(Regjistrim i ri, i pjesshëm.)

7. * COBISS.net

001	␣␣	**a**n **b**y **c**j
250	␣␣	**a**Grupet etnike, popujt etj. (India)
		(Regjistrim i ri, udhëzues.)

 © IZUM, prill 2020, përkthimi në gjuhën shqipe: tetor 2020

010 IDENTIFIKUESI STANDARD NDËRKOMBËTAR I EMRAVE (ISNI)

Fusha përmban treguesin standard ndërkombëtar të emrave (ISNI). Ky numër siguron identifikimin e identiteteve të pjesmarrësve, që i përdorimin publikisht në krijimtarinë e tyre, prodhimin, administrimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve në industrinë mediatike.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
010		Identifikuesi Standard Ndërkombëtar i Emrave (ISNI)	nr
	a	*Numri*	nr
	y	*ISNI e anuluar*	r
	z	*ISNI e gabuar*	r

Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

010a Numri

ISNI përbëhet nga 16 numra, pa hapësira mes tyre. Nënfusha a është e detyrueshme, nëse është e pranishme nënfusha z.

010y ISNI e anuluar

Numri i ISNI-së që ka qenë i vlefshëm, mirëpo institucioni për ndarjen e ISNI-së e ka anuluar.

010z ISNI e gabuar

ISNI që është përdorur gabimisht tek identitetet e caktuara ose është i pavlefshëm në ndonjë mënyrë tjetër. Mund t'i jetë ndarë dy identiteteve të ndryshme dhe për këtë arsye është anuluar.

© IZUM, shtator 2018, përkthimi në gjuhën shqipe: tetor 2020

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

ISNI ndahet nga institucionet për ndarjen e ISNI-së sipas sistemit të centralizuar dhe në përputhje me ISO 27729. ISNI është numër »memec«, sepse asnjë pjesë e tij nuk ka ndonjë kuptim të rëndësishëm.

Në standardin ISO 27729 është e përcaktuar:

- pjesmarrësi mund të ketë më shumë se një identitet publik dhe secili nga ata identifikohet me numrin e tij të ISNI-së;
- i njëjti numër i ISNI-së mund të vlej vetëm për një identitet publik të pjesmarrësit;
- drejtshkrimi alternativ, prezantimi alternativ, variantet e simboleve, shkrimet ose variantet e gjuhëve nuk mjaftojnë për ndarjen e numrave të ndryshëm të ISNI-së.

Forma e të dhënave

ISNI përbëhet nga 15 numra, pas të cilëve është numri i kontrollit. Numri i kontrollit mund të jetë nga 0 deri në 9, ose simboli X, i cili llogaritet në bazë të 15 numrave të parë në përputhje me ISO/IEC 7064, sipas algoritmit MOD11-2.

Numri 16 shifror i ISNI-së shënohet në formë të ngjeshur, pa hapësira apo shenja pikësimi. Para numrave nuk vendoset shenja e ISNI-së.

Për përdoruesit ISNI shfaqet si një numër 16 shifror, i ndarë në katër pjesë me nga katër numra, pjesët të ndara mes mes vete me hapësirë. Para tyre ndodhet shkurtesa ISNI dhe hapësira.

ISNI është i përdorshëm dhe i zbërthyeshëm si http:/www.isni.org/XXXXXXXXXXXXXXXX

FUSHAT NË LIDHSHMËRI

200 *PIKËQASJA E NJËSUAR – EMËR VETJAK*
210 *PIKËQASJA E NJËSUAR – EMËR ORGANIZATE*
220 *PIKËQASJA E NJËSUAR – EMËR FAMILJE*
400 *VARIANTI I PIKËQASJES – EMËR VETJAK*
410 *VARIANTI I PIKËQASJES – EMËR ORGANIZATE*
420 *VARIANTI I PIKËQASJES – EMËR FAMILJE*

SHEMBUJ

1.

010	␣␣	**a**0000000121035067
200	␣1	**a**Lévi-Strauss **b**Claude **f**1908-2009
300	0␣	**a**Philosophe et anthropologue
300	0␣	**a**Membre de l'Académie française (élu en 1974)
400	␣1	**a**Strauss **b**Claude Lévi- **f**1908-2009
400	␣1	**a**Lévy-Strauss **b**Claude **f**1908-2009
400	␣1	**a**Strauss **b**Claude Lévy- **f**1908-2009

 © IZUM, shtator 2018, përkthimi në gjuhën shqipe: tetor 2020

715 PIKËQASJA E NJËSUAR NË GJUHËN DHE/OSE SHKRIMIN TJETËR – EMËR I NJËSISË POLITIKE-TERRITORIALE OSE EMËR GJEOGRAFIK

Fusha përmban pikëqasjen për emrin e njësisë politike-territoriale ose emrin gjeografik, që është në një gjuhë dhe/ose shkrimi tjetër nga ai pikëqasjes në fushën 215.

Emrat e njësive politike-territoriale që përdoren si pikëqasje lëndore, të vetme ose vetëm me përcaktuesit e shtuar lëndorë, trajtohen si emra territoresh (fusha 715). Emrat e njësive politike-territoriale që përdoren si pikëqasje për autorët, trajtohen si organizata (fusha 710). Si organizata trajtohen edhe emrat e njësive politike-territoriale, pas të cilëve ndodhet nënndarja për organizatën dhe të cilët përdoren si pikëqasje për autorët ose si pikëqasje lëndore.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
715		Pikëqasja e njësuar në gjuhën dhe/ose shkrimin tjetër – emër i njësisë politike-territoriale ose emër gjeografik	r
	a	*Elementi hyrës*	nr
	x	*Përcaktuesi i përgjithshëm*	r
	z	*Përcaktuesi kohor*	r
	2	*Kodi i sistemit*	nr
	8	*Gjuha e katalogimit*	nr
	9	*Gjuha e pjesës kryesore të pikëqasjes*	nr

Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

Nënfusha a është përshkruar tek fusha 215, nënfusha x dhe z në kapitullin *Përcaktuesit*, ndërsa nënfusha 2, 8 dhe 9 në kapitullin *Nënfushat e kontrollit*.

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përmban formën e emrit të njësisë politike-territoriale ose emrit gjeografik, që është formuar në përputhje me rregullat kombëtare të katalogimit ose me sistemin e emërtimeve lëndore dhe është e lidhur me formën në fushën 215.

FUSHAT NË LIDHSHMËRI

215 *PIKËQASJA E NJËSUAR – EMËR I NJËSISË POLITIKE-TERRITORIALE OSE EMËR GJEOGRAFIK*

SHEMBUJ

1.

001	␣␣	**a**A123456
215	␣␣	**a**Schweiz
715	␣␣	**8**fre **a**Suisse
715	␣␣	**8**ita **a**Svizzera
		(Regjistrim në katalogun në gjuhën gjermane.)

001	␣␣	**a**A234567
215	␣␣	**a**Suisse
715	␣␣	**8**ger **a**Schweiz
715	␣␣	**8**ita **a**Svizzera
		(Regjistrim në katalogun në gjuhën franceze.)

001	␣␣	**a**A345678
215	␣␣	**a**Svizzera
715	␣␣	**8**ger **a**Schweiz
715	␣␣	**8**fre **a**Suisse
		(Regjistrim në katalogun në gjuhën italiane.)

2. *

100	␣␣	**b**a **c**slv **g**ba
152	␣␣	**b**sgc
215	␣␣	**a**Sava (vodotok)
715	␣␣	**2**sgce **8**eng **a**Sava River
		(Fusha 715 përmban formën e emrit në gjuhën angleze që korrespondon me formën e emrit në gjuhën sllovene në fushën 215.)

3. *

100	␣␣	**b**a **c**slv **g**ba
152	␣␣	**b**sgc
215	␣␣	**a**Koroška (Avstrija)
715	␣␣	**2**sgce **8**eng **a**Carinthia (Austria)
		(Fusha 715 përmban formën e emrit në gjuhën angleze që korrespondon me formën e emrit në gjuhën sllovene në fushën 215.)

4. * COBISS.net

100	␣␣	**b**a **c**alb **g**ba
152	␣␣	**b**sgc
215	␣␣	**a**Akropoli (Athinë, Greqi)
715	␣␣	**2**sgce **8**eng **a**Acropolis (Athens, Greece)

 © IZUM, prill 2020, përkthimi në gjuhën shqipe: tetor 2020

		(Fusha 715 përmban formën e emrit në gjuhën angleze që korrespondon me formën e emrit në gjuhën shqipe në fushën 215.)

5. * COBISS.net

100	␣␣	**b**a **c**alb **g**ba
152	␣␣	**b**sgc
215	␣␣	**a**Tsavo (Keni ; park kombëtar)
715	␣␣	**2**sgce **8**eng **a**Tsavo National Park (Kenya) *(Fusha 715 përmban formën e emrit në gjuhën angleze që korrespondon me formën e emrit në gjuhën shqipe në fushën 215.)*

720 PIKËQASJA E NJËSUAR NË GJUHË DHE/APO SHKRIM TJETËR – EMËR FAMILJE

Fusha përmban pikëqasjen e njësuar për emrin e familjes, që është një një gjuhë dhe/apo shkrim tjetër nga pikëqasja në fushën 220.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
720		Pikëqasja e njësuar në gjuhë dhe/apo shkrim tjetër – emër familje	r
	a	*Elementi hyrës*	nr
	c	*Lloji i familjes*	nr
	f	*Datat*	nr
	2	*Kodi i sistemit*	nr
	8	*Gjuha e katalogimit*	nr
	9	*Gjuha e pjesës kryesore të pikëqasjes*	nr

Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

Nënfusha a, c dhe f janë përshkruar te fusha 220, ndërsa nënfushat 2, 8 dhe 9 në kapitullin *Nënfushat e kontrollit*.

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përmban formën e emrit të familjes, që është përcaktuar sipas rregullave kombëtare të katalogimit ose sipas sistemit të emërtimeve lëndore dhe është e lidhur me formën në fushën 220.

FUSHAT NË LIDHSHMËRI

220 *PIKËQASJA E NJËSUAR – EMËR FAMILJE*

SHEMBUJ

1. * COBISS.net

220	␣␣	**a**Habsburgët **c**familje sundimtarësh
720	␣␣	**2**sgce **8**eng **a**Habsburg **c**House of
		(Në fushën 720 është forma e emrit në gjuhën angleze nga fusha 220.)

2. * COBISS.net

220	␣␣	**a**Bach **c**familje
720	␣␣	**2**sgce **8**eng **a**Bach family
		(Në fushën 720 është forma e emrit në gjuhën angleze nga fusha 220.)

 © IZUM, mars 2018, përkthimi në gjuhën shqipe: tetor 2020

730 PIKËQASJA E NJËSUAR NË GJUHË DHE/APO SHKRIM TJETËR – TITULL

Fusha përmban pikëqasjen e njësuar për titullin, që është në një gjuhë dhe/apo shkrim tjetër nga pikëqasja në fushën 230.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
730		Pikëqasja e njësuar në gjuhë dhe/apo shkrim tjetër – titull	r
	a	*Elementi hyrës*	nr
	b	*Përcaktimi i përgjithshëm i materialit*	r
	h	*Numri i pjesës*	r
	i	*Titulli i pjesës*	r
	k	*Data e botimit*	nr
	l	*Nënndarje forme*	nr
	m	*Gjuha*	nr
	n	*Të dhëna të ndryshme*	nr
	q	*Versioni (ose data e versionit)*	nr
	r	*Mënyra e ekzekutimit (në muzikë)*	r
	s	*Përcaktuesi numerik (në muzikë)*	r
	u	*Tonaliteti (në muzikë)*	nr
	w	*Të dhëna për aranzhimin (në muzikë)*	nr
	2	*Kodi i sistemit*	nr
	8	*Gjuha e katalogimit*	nr
	9	*Gjuha e pjesës kryesore të pikëqasjes*	nr

Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

Nënfushat nga a deri w janë përshkruar tek fusha 230, ndërsa nënfusha 2, 8 dhe 9 në kapitullin *Nënfushat e kontrollit*.

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përmban formën e titullit, që është përcaktuar në përputhje me rregullat kombëtare të katalogimit ose me sistemin e emërtimeve lëndore dhe është e lidhur me formën në fushën 230.

FUSHAT NË LIDHSHMËRI

230 *PIKËQASJA E NJËSUAR – TITULL*

SHEMBUJ

1. * COBISS.net

230	␣␣	**a**Dorëshkrimet Qumran
730	␣␣	**2**sgce **8**eng **a**Dead Sea scrolls
		(Në fushën 730 është forma e titullit në gjuhën angleze nga fusha 230.)

2. * COBISS.net

230	␣␣	**a**Guri Rosetta
730	␣␣	**2**sgce **8**eng **a**Rosetta stone
		(Në fushën 730 është forma e titullit në gjuhën angleze nga fusha 230.)

 © IZUM, qershor 2021, përkthimi në gjuhën shqipe: qershor 2021

740 PIKËQASJA E NJËSUAR NË GJUHË DHE/APO SHKRIM TJETËR – EMËR/TITULL

Fusha përmban pikëqasjen e njësuar për emrin/titullin, që është në një gjuhë dhe/apo shkrim tjetër nga pikëqasja në fushën 240.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
740		Pikëqasja e njësuar në gjuhë dhe/apo shkrim tjetër – emër/titull	r
	a	*Emri*	nr
	t	*Titulli*	nr
	2	*Kodi i sistemit*	nr
	8	*Gjuha e katalogimit*	nr
	9	*Gjuha e pjesës kryesore të pikëqasjes*	nr

Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

Nënfusha a dhe t janë përshkruar në fushën 240, ndërsa nënfushat 2, 8 dhe 9 në kapitullin *Nënfushat e kontrollit*.

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përmban formën e emrit/titullit që është përcaktuar në përputhje me rregullat kombëtare të katalogimit ose me sistemin e emërtimeve lëndore dhe është lidhur me formën në fushën 240.

FUSHAT NË LIDHSHMËRI

240 *PIKËQASJA E NJËSUAR – EMËR/TITULL*

743 PIKËQASJA E NJËSUAR NË GJUHË DHE/APO SHKRIM TJETËR – EMËR/TITULL KONVECIONAL PËR TEKSTET LIGJORE DHE FETARE

Fusha përmban pikëqasjen e njësuar për emrin/titullin konvencional për tekstet ligjore dhe fetare, që janë në gjuhë dhe/apo shkrim tjetër nga pikëqasja në fushën 243.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
743		Pikëqasja e njësuar në gjuhë dhe/apo shkrim tjetër – emër/titull konvecional për tekstet ligjore dhe fetare	r
	a	*Elementi hyrës*	nr
	t	*Titulli konvencional*	nr
	2	*Kodi i sistemit*	nr
	8	*Gjuha e katalogimit*	nr
	9	*Gjuha e pjesës kryesore të pikëqasjes*	nr

Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		***Nuk është i përcaktuar***
2		***Mënyra e shënimit të emrit***
	1	*emër i shënuar sipas shtetit ose emrave të tjerë gjeografik*
	2	*emër i shënuar sipas formës tjetër të emrit*

Vlera "1" e treguesit të dytë përdoret te emrat gjeografik nën juridiksion.

Vlera "2" e treguesit të dytë përdoret te emrat e kishës.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

Nënfushat a dhe t janë përshkruar tek fusha 243, ndërsa nënfusha 2, 8 dhe 9 në kapitullin *Nënfushat e kontrollit*.

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përmban formën e emrit/titullit konvencional, që është përcaktuar në përputhje me rregullat kombëtare të katalogimit ose me sistemin e emërtimeve lëndore dhe është e lidhur me formën në fushën 243.

FUSHAT NË LIDHSHMËRI

243 *PIKËQASJA E NJËSUAR – EMËR/TITULL KONVENCIONAL PËR TEKSTET LIGJORE DHE FETARE*

 © IZUM, tetor 2022, përkthimi në gjuhën shqipe: nëntor 2022

750 PIKËQASJA E NJËSUAR NË GJUHË DHE/APO SHKRIM TJETËR – EMËR I PËRGJITHSHËM

Fusha përmban pikëqasjen për emrin e përgjithshëm, që është në një gjuhë dhe/apo shkrim tjetër nga pikëqasja në fushën 250.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
750		Pikëqasja e njësuar në gjuhë dhe/apo shkrim tjetër – emër i përgjithshëm	r
	a	*Elementi fillestar*	nr
	x	*Përcaktuesi i përgjithshëm*	r
	y	*Përcaktuesi gjeografik*	r
	z	*Përcaktuesi kohor*	r
	2	*Kodi i sistemit*	nr
	8	*Gjuha e katalogimit*	nr
	9	*Gjuha e pjesës kryesore të pikëqasjes*	nr

Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

Nënfusha a është përshkruar tek fusha 250, nënfusha x, y dhe z në kapitullin *Përcaktuesit*, ndërsa nënfusha 2, 8 dhe 9 në kapitullin *Nënfushat e kontrollit*.

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përmban formën e emrit të përgjithshëm që është formuar në përputhje me sistemin e emërtimeve lëndore dhe është i lidhur me formën në fushën 250.

FUSHAT NË LIDHSHMËRI

250 *PIKËQASJA E NJËSUAR – EMËR I PËRGJITHSHËM*

SHEMBUJ

1. * COBISS.net

250	␣␣	**a**Antropologjia
750	␣␣	**2**sgce **8**eng **a**Anthropology

 © IZUM, prill 2020, përkthimi në gjuhën shqipe: tetor 2020

780 PIKËQASJA NË LIDHSHMËRI NË GJUHËN DHE/OSE SHKRIMIN TJETËR – FORMA, ZHANRI OSE KARAKTERISTIKAT FIZIKE

Fusha përmban pikëqasjen e njësuar për formën, zhanrin ose karakteristikat fizike, që është një një gjuhë dhe/apo shkrim tjetër nga pikëqasja në fushën 280.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
780		Pikëqasja në lidhshmëri në gjuhën dhe/ ose shkrimin tjetër – forma, zhanri ose karakteristikat fizike	r
	a	*Elementi hyrës*	nr
	x	*Përcaktuesi i përgjithshëm*	r
	y	*Përcaktuesi gjeografik*	r
	z	*Përcaktuesi kohor*	r
	2	*Kodi i sistemit*	nr
	8	*Gjuha e katalogimit*	nr
	9	*Gjuha e pjesës kryesore të pikëqasjes*	nr

Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

Nënfusha a është përshkruar tek fusha 280, nënfusha x, y dhe z në kapitullin *Përcaktuesit*, ndërsa nënfusha 2, 8 dhe 9 në kapitullin *Nënfushat e kontrollit*.

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përmban pikëqasjen për formën, zhanrin ose karakteristikat fizike, që është përcaktuar në përputhje me sistemin e emërtimeve lëndore dhe është e lidhur me pikëqasjen në fushën 280.

FUSHAT NË LIDHSHMËRI

280 *PIKËQASJA E NJËSUAR – FORMA, ZHANRI OSE KARAKTERISTIKAT FIZIKE*

SHEMBUJ

1.

152	␣␣	**b**rbpap
280	␣␣	**a**Marbled papers
480	␣␣	**a**Marble papers
580	␣␣	**5**g **a**[Surface applications of paper]
580	␣␣	**5**h **a**Antique marbled papers
580	␣␣	**5**h **a**British marbled papers
580	␣␣	**5**h **a**Cocoa marbled papers
780	␣␣	**8**fre **9**fre **a**Papiers marbrés *(Përparësia e termit* Marbled papers *nga Thesari për katalogimin e librave të rrallë dhe koleksioneve të veçanta* Thesaurus for use in rare book and special collections cataloguing *është në katalogun në dy gjuhë, të përkthyer në gjuhën franceze.)*

2. * COBISS.net

152	␣␣	**b**sgc
280	␣␣	**a**Harta relief
780	␣␣	**2**sgce **8**eng **a**Relief maps

3. * COBISS.net

152	␣␣	**b**sgc
280	␣␣	**a**Muzikë me kitarë
780	␣␣	**2**sgce **8**eng **a**Guitar music *(Forma e termit në gjuhën angleze e vendosur në fushën 780 korrespondon me formën në gjuhën shqipe të vendosur në fushën 280.)*

4. * COBISS.net

152	␣␣	**b**sgc
280	␣␣	**a**Esetë
780	␣␣	**2**sgce **8**eng **a**Essays

5. * COBISS.net

001	␣␣	**a**n **b**y **c**l
152	␣␣	**b**sgc
280	␣␣	**a**Muzika **z**Shekulli 17
780	␣␣	**2**sgce **8**eng **a**Music **z**17th century *(Regjistrim referues nga SGC.)*

 © IZUM, prill 2020, përkthimi në gjuhën shqipe: tetor 2020

8XX BLLOKU I INFORMACIONIT PËR BURIMIN E TË DHËNAVE

LISTA E FUSHAVE

801 Origjina e regjistrimit
810 E dhëna është në
815 E dhëna nuk është në
820 Të dhënat për përdorimin ose qëllimin
830 Shënime të përgjithshme të kataloguesit
835 Të dhënat për pikëqasjen e fshirë
836 Të dhënat për pikëqasjen e zëvendësuar
856 Vendndodhja elektronike dhe qasja

Shënimet përmbajnë të dhëna për institucionet që janë përgjegjëse për regjistrimin, si dhe shënimet e kataloguesve nga këto institucione. Shënimet e kataloguesve shërbejnë si udhëzime për kataloguesit e tjerë, për këtë arsye nuk janë të përshtatshme për shfaqje publike. Shënimet publike vendosen në bllokun *3XX – Blloku i shënimeve*.

801 ORIGJINA E REGJISTRIMIT

Në këtë fushë vendoset institucioni, i cili është përgjegjës për krijimin e regjistrimit, dhe data e vendosjes së të dhënave. Fusha përsëritet për shënimin e institucionit që regjistrimin e ka transkriptuar, ndryshuar ose publikuar. Data te regjistrimet e reja është data e krijimit të regjistrimit. Te regjistrimet e redaktuara kjo është data e redaktimit të fundit.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
801		Origjina e regjistrimit	r
	a	*Shteti*	nr
	b	*Institucioni*	nr
	c	*Data e veprimit të fundit*	nr

Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		***Nuk është i përcaktuar***
2		***Funksioni i institucionit***
	0	*institucioni katalogues*
	1	*institucioni që kopjon të dhënat*
	2	*institucioni që ndryshon të dhënat*
	3	*institucioni që publikon regjistrimin*

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

801a Shteti

Kodi i shtetit, në të cilin ndodhet institucioni që ka publikuar regjistrimin. Kodi është në përputhje me standardin ISO 3166.

801b Institucioni

Kodi i institucionit nga *MARC Code List for Organizations*.

801c Data e veprimit të fundit

Data e veprimit të fundit, e shënuar në formën VVVVMMDD, në përputhje me standardin ISO 8601.

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Një institucion mund të krye disa ose të gjitha funksionet. Fusha përsëritet vetëm nëse janë ndryshuar të dhënat për datën e veprimit të fundit, rregullat e katalogimit ose formatin. Nëse në regjistrim nuk janë bërë ndryshime, në të ndodhet vetëm fusha që është plotësuar e para.

FUSHAT NË LIDHSHMËRI

100 *TË DHËNAT E PËRGJITHSHME PËR PËRPUNIMIN*

SHEMBUJ

1.

801	␣0	**a**US **b**DLC **c**19800516

2.

801	␣3	**a**GB **b**bl **c**19831121

3.

801	␣0	**a**FR **b**FR-693836101 **c**20070215 *(Regjistrim i njësuar, i krijuar në* Bibliothèque nationale de France*.)*

4.

801	␣0	**a**RU **b**NLR **c**19961109

5. *

801	␣0	**a**usa **b**NNHWW
801	␣1	**a**usa **b**NNHWW **c**19821215
801	␣2	**a**svn **b**SI-MaIIZ *(Dy fushat e para kanë kodin e institucionit që është përgjegjës për katalogimin dhe kopjimin e regjistrimit.)*

 © IZUM, shtator 2018, përkthimi në gjuhën shqipe: tetor 2020

810 E DHËNA ËSHTË NË

Fusha përmban të dhënat për burimin në të cilin është gjetur e dhëna për pikëqasjen. Zakonisht shënohet burimi bibliografik, gjatë katalogimit të të cilit është formuar pikëqasja.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
810		E dhëna është në	r
	a	*Të dhënat për burimin*	nr
	b	*E dhëna e gjetur*	nr

Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

810a Të dhënat për burimin

E dhëna për burimin, në të cilin keni gjetur formën e pikëqasjes.

810b E dhëna e gjetur

Nënfusha përmban të dhënën e gjetur në burim, që është vendosur në nënfushën a (shih shembujt 1, 4, 5).

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Në fushën e përsëritshme vendoset burimi i të dhënave për çdo formë të emrit.

FUSHAT NË LIDHSHMËRI

2XX *BLLOKU I PIKËQASJEVE TË NJËSUARA*
4XX *BLLOKU I VARIANTEVE TË PIKËQASJEVE*
5XX *BLLOKU I PIKËQASJEVE NË LIDHSHMËRI*

7XX *BLLOKU I PIKËQASJEVE TË NJËSUARA NË GJUHËT DHE/APO SHKRIMET E TJERA*

SHEMBUJ

1.

200	␣1	**a**Avery, **b**Harold Eric
400	␣1	**a**Avery, **b**H.E.
810	␣␣	**a**His Advanced physical chemistry calculations, 1971: t.p. **b**(H. E. Avery, B.Sc., Ph.D., Dept. of Chem., Liverpool Polytechnic)

2.

200	␣1	**a**Hailsham of Saint Marylebone, **b**Quintin Hogg, **c**Baron
810	␣␣	**a**Who's Who

3. * COBISS.net

200	␣1	**a**Latifi **b**Drita
400	␣1	**5**k **a**Basha **b**Drita
810	␣␣	**a**Dita e mirë thërret / Drita Latifi. - 1999
810	␣␣	**a**Dashuria ka krahë / Drita Basha. - 1992

4. * COBISS.net

200	␣1	**a**Herberstein **b**Žiga
400	␣1	**a**Herberstein **b**Sigismund
810	␣␣	**a**Enciklopedia e Sllovenisë **b**Žiga Herberstein
810	␣␣	**a**Leksikon biografik slloven **b**Sigismund Herberstein

5. * COBISS.net

250	␣␣	**a**Dolomit
450	␣␣	**a**Grintavec (Kamnina)
450	␣␣	**a**Kalavec
810	␣␣	**a**Fjalor terminologjik gjeologjik, 2006 **b**(dolomit: grintavec, kalavec)

 © IZUM, mars 2018, përkthimi në gjuhën shqipe: tetor 2020

815 E DHËNA NUK ËSHTË NË

Në këtë fushë vendosen burimet që janë kontrolluar, mirëpo në to nuk janë gjetur të dhënat për pikëqasjen.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
815		E dhëna nuk është në	nr
	a	*Të dhënat për burimin*	r

Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

815a Të dhënat për burimin

Të dhënat për cilindo burim, në të cilin nuk keni gjetur formën e pikëqasjes. Nënfusha përsëritet për çdo burim.

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha nuk është e detyrueshme, mirëpo rekomandohet shënimi i burimeve të kontrolluara.

FUSHAT NË LIDHSHMËRI

2XX *BLLOKU I PIKËQASJEVE TË NJËSUARA*
4XX *BLLOKU I VARIANTEVE TË PIKËQASJEVE*
5XX *BLLOKU I PIKËQASJEVE NË LIDHSHMËRI*
7XX *BLLOKU I PIKËQASJEVE TË NJËSUARA NË GJUHËT DHE/APO SHKRIMET E TJERA*

SHEMBUJ

1.

200	␣1	**a**Jones, **b**A. Wesley
815	␣␣	**a**Dir. Amer. schol., 1974; **a**National faculty dir., 1979; **a**Amer. men/women sci., soc. and beh. sci., 1978; **a**WWA., 1978-79

2. * COBISS.net

200	␣1	**a**Reka **b**Kastriot
810	␣␣	**a**Teknika dhe puna. Manual për klasën e 5-të / Kastriot Reka. - 2001
815	␣␣	**a**Wikipedia

3. *

152	␣␣	**a**sgc
250	␣␣	**a**Fragmentacija pomnilnika (računalništvo)
815	␣␣	**a**ISLOVAR : slovar informatike: http://www.islovar.org/ **a**Leksikon računalništva in informatike, 2002

 © IZUM, mars 2018, përkthimi në gjuhën shqipe: tetor 2020

820 TË DHËNAT PËR PËRDORIMIN OSE QËLLIMIN

Në këtë fushë shënohen të dhënat që kufizojnë përdorimin e pikëqasjes në fushën 2XX ose shpjegojnë shembujt e entiteteve me të njëjtin emër ose me emër të ngjashëm.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
820		Të dhënat për përdorimin ose qëllimin	r
	a	*Teksti i shënimit*	r

Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

820a Teksti i shënimit

Nënfusha përmban tekstin e shënimit.

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha nuk është e detyrueshme, mirëpo rekomandohet vendosja e shënimit sa herë që mendoni se mund të vije deri tek ngatërrimi për shkak të pikëqasjeve të ngjashme.

FUSHAT NË LIDHSHMËRI

2XX *BLLOKU I PIKËQASJEVE TË NJËSUARA*

SHEMBUJ

1.

200	␣1	**a**Smithe, **b**Sam
820	␣␣	**a**Not to be confused with Smith, Sam

2.

200	␣1	**a**Lafontaine, **b**Jacques, **f**1944-
820	␣␣	**a**Ne pas confondre avec l'auteur né en 1933.

3. * COBISS.net

200	␣1	**a**Gashi **b**Arben **r**<nnn> **f**1979-
820	␣␣	**a**Mos e ngatërro me: Gashi, Arben (përkthyes)
820	␣␣	**a**Mos e ngatërro me: Gashi, Arben, 1955-2015
820	␣␣	**a**Mos e ngatërro me: Gashi, Arben (ekonomist)
820	␣␣	**a**Mos e ngatërro me: Gashi, Arben, 1963- (mjek)
820	␣␣	**a**Ekzistojnë disa autorë me të njëjtin emër, në fushëveprimtari të ndryshme.

4. * COBISS.net

200	␣1	**a**Štiglic **b**Franc
820	␣␣	**a**Mos e ngatërro me: Štiglic, France, 1919- (regjisor filmi)

 © IZUM, mars 2018, përkthimi në gjuhën shqipe: tetor 2020

830 SHËNIME TË PËRGJITHSHME TË KATALOGUESIT

Në fushë vendosen të dhënat biografike, historike ose të dhënat e tjera për pikëqasjen.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
830		Shënime të përgjithshme të kataloguesit	r
	a	*Teksti i shënimit*	r

Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

830a Teksti i shënimit

Nënfusha përmban tekstin e shënimit.

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Në këtë fushë mund të vendoset edhe e dhëna për rregullat që janë përdorur, shpjegimi se përse keni përzgjedhur atë formë të pikëqasjes etj. (shih shembullin 2). Këto lloj të dhënash mund të shfaqen edhe në fushat e tjera, p.sh. në fushën 810.

SHEMBUJ

1.

200	␣1	**a**Korman, **b**Gerd
830	␣␣	**a**b. 1928; **a**PhD

2.

200	␣1	**a**Otter, **b**A.A. den, **f**1941-
830	␣␣	**a**AACR2 22.4A. Name established according to author's preference.

3. * COBISS.net

200	␣1	**a**Ružič **b**Ernest
400	␣0	**5**z **a**E. R.

400	␣0	**5**z **a**ER
830	␣␣	**a**Nënshkruhet edhe si: e. R. dhe eR

4. * COBISS.net

200	␣1	**a**Sahiti **b**Ermira **f**1950-
830	␣␣	**a**Fusha e veprimtarisë: drejtësia, sistemet informative, skenarët, politika. Të dhënat e marra nga autori.

5. * COBISS.net

200	␣0	**a**Orakelj
830	␣␣	**a**Orakelj është pseudonim. Autori nuk dëshiron të zbulohet. *(Regjistrimi nuk ka emrin e vërtetë. Shënimi nuk është publik.)*

6. * COBISS.net

250	␣␣	**a**Letërsia egjiptiane në gjuhën arabe
830	␣␣	**a**Shënim i redaktorit: Lidhja në LCSH "Egyptian literature, Modern" nuk shtohet.

 © IZUM, mars 2018, përkthimi në gjuhën shqipe: tetor 2020

835 TË DHËNAT PËR PIKËQASJEN E FSHIRË

Fusha shpjegon se përse pikëqasja në fushën 2XX është fshirë nga baza e njësuar e të dhënave. Fusha 835 plotësohet në regjistrimet, në të cilat në nënfushën *001a – Statusi i regjistrimit* ndodhet kodi *"d" – regjistrim i fshirë* ose *"r" – regjistrim i ndarë*.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
835		Të dhënat për pikëqasjen e fshirë	r
	a	*Teksti i shënimit*	r
	b	*Pikëqasja zëvendësuese*	r
	d	*Data e veprimit*	nr

Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

835a Teksti i shënimit

Nënfusha përmban shpjegimin.

835b Pikëqasja zëvendësuese

Nënfusha përmban pikëqasjen, e cila ka zëvendësuar pikëqasjen e fshirë në fushën 2XX.

835d Data e veprimit

Data e veprimit shënohet në formën VVVVMMDD. Nëse përdorni fushën 835, plotësimi i kësaj nënfushe është i domosdoshëm.

FUSHAT NË LIDHSHMËRI

001a *ETIKETA E REGJISTRIMIT, Statusi i regjistrimit*

SHEMBUJ

1. * COBISS.net

001	␣␣	**a**r
200	␣1	**a**Bartol **b**Tomaž
835	␣␣	**a**Adashë **b**Bartol, Tomaž, 1962- **b**Bartol, Tomaž, 1968- **d**20011212

 © IZUM, mars 2018, përkthimi në gjuhën shqipe: tetor 2020

836 TË DHËNAT PËR PIKËQASJEN E ZËVENDËSUAR

Fusha shpjegon se pikëqasja në fushën 2XX ka zëvendësuar pikëqasjen në fushën 836. Fusha 836 mund të plotësohet në regjistrimet, në të cilat në nënfushën *001a – Statusi i regjistrimit* ndodhet kodi *"c" – regjistrim i korigjuar* ose *"n" – regjistrim i ri*.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
836		Të dhënat për pikëqasjen e zëvendësuar	r
	b	*Pikëqasje e zëvendësuar*	nr
	d	*Data e veprimit*	nr

Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

836b Pikëqasje e zëvendësuar

Nënfusha përmban pikëqasjen, e cila është zëvendësuar me pikëqasjen në fushën 2XX.

836d Data e veprimit

Data e veprimit shënohet në formën VVVVMMDD. Nëse përdorni fushën 836, plotësimi i kësaj nënfushe është i domosdoshëm.

FUSHAT NË LIDHSHMËRI

001a *ETIKETA E REGJISTRIMIT, Statusi i regjistrimit*

SHEMBUJ

1.

001	␣␣	**a**n

200	␣1	**a**De Clerck **b**Charles
836	␣␣	**b**Clerck, Charles de **d**19871125

2. *

001	␣␣	**a**n
200	␣1	**a**Milčinski **b**Fran **f**1867-1932
836	␣␣	**b**Milčinski, Fran **d**20011212

 © IZUM, mars 2018, përkthimi në gjuhën shqipe: tetor 2020

856 VENDNDODHJA ELEKTRONIKE DHE QASJA

Kjo fushë në regjistrimet e njësuara mund të përdoret për sigurimin e të dhënave shtesë (elektronike) për entitetin, për të cilin është krijuar regjistrimi.

Fusha përmban të dhëna për vendin ku ndodhet ose ku mundësohet qasja në njësinë elektronike. Përmban edhe të dhënat që mundësojnë qasjen në njësi; mënyra e qasjes është përcaktuar përmes vlerës së treguesit.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
856		Vendndodhja elektronike dhe qasja	r
	a	*Emri i strehuesit (host)*	r
	b	*Numri i qasjes*	r
	c	*Të dhënat për ngjeshjen*	r
	d	*Shtegu*	r
	e	*Data dhe ora e kontrollimit dhe qasjes*	nr
	f	*Emri elektronik*	r
	g	*Emri uniform i burimit (URN)*	r
	h	*Ekzekutuesi i kërkesës (emri i përdoruesit)*	nr
	i	*Instruksioni*	r
	j	*Bajt për sekondë (BPS)*	nr
	k	*Fjalëkalimi*	nr
	l	*Lidhja me rrjetin*	nr
	m	*Ndihma për qasje*	r
	n	*Emri i vendndodhjes së strehuesit në nënfushën a*	nr
	o	*Sistemi operativ*	nr
	p	*Porta*	nr
	q	*Lloji i skedarit*	nr
	r	*Parametrat*	nr
	s	*Madhësia e skedarit*	r
	t	*Imitimi i skajshëm*	r
	u	*Vendndodhja unike e burimit (URL)*	nr
	v	*Orët kur qasja është e mundshme*	r
	x	*Shënimi i brendshëm*	r
	y	*Mënyra e qasjes*	nr
	w	*Numri i kontrollit të regjistrimit*	r
	z	*Shënimi publik*	r

Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		***Mënyra e qasjes***
	0	*postë elektronike*
	1	*FTP*
	2	*lidhje në distancë (telnet)*
	3	*lidhje me telefon*
	4	*HTTP*

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
	7	*mënyrë e specifikuar në nënfushën y*
	␣	*nuk ka të dhëna*
2		***Nuk është i përcaktuar***

Treguesi i parë përshkruan mënyrën e qasjes në burimin elektronik.

Nëse treguesi i parë ka vlerën "0", qasja në burimin elektronik është i mundur përmes postë elektronike. Nëse treguesi i parë ka vlerën "1" në fushat përkatëse mund të shënohen të dhënat e nevojshme për transferimin e burimit elektronik. Nëse treguesi i parë ka vlerën "2" dhe "3" shënohen të dhënat për mënyrën e lidhjes me burimin.

Vlera "7" e treguesit të parë përdoret te mënyra ndryshe e qasjes (vendoset në nënfushën y) në burimin elektronik.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

856a Emri i strehuesit (host)

Nënfusha përmban adresën e strehuesit dhe përsëritet nëse i njëjti strehues ka disa adresa.

856b Numri i qasjes

Kjo e dhënë mund të jetë protokolli i internetit (IP) nëse njësia është në internet, ose numri i telefonit nëse qasja është e mundur nëpërmjet lidhjes telefonike. Këto të dhëna mund të ndryshojnë shpesh dhe mund të përditësohen në mënyrë automatike. Numri i telefonit shënohet në formën [kodi i shtetit]-[kodi i zonës]-[numri i telefonit] p.sh. 49-69-15251140 (numri në Frankfurt, Gjermani), 1-202-7076237 (numri në Washington, D.C., në SHBA). Nëse është edhe ndonjë numër i brendshëm (intern) ai shënohet pas numrit të telefonit. Numri i telefonit dhe numri i brendshëm mes tyre ndahen me "x" p.sh. 1-703-3589800x515 (numër telefoni me numër të brendshëm).

856c Të dhënat për ngjeshjen

Nënfusha përdoret kur nevojitet program i veçantë për çngjeshjen e të dhënave.

856d Shtegu

Vendoset emri i direktorisë/nëndirektorisë, në të cilin ndodhet skedari.

 © IZUM, mars 2018, përkthimi në gjuhën shqipe: tetor 2020

856e Data dhe ora e kontrollimit dhe qasjes

Koha e qasje së fundit në burimin elektronik në formën VVVVMMDDOOMM.

856f Emri elektronik

Shënohet emri i skedarit siç është në direktorinë/nëndirektorinë e shënuar në nënfushën d dhe në strehuesin e shënuar në nënfushën a. Nënfusha f mund të përsëritet nëse skedari i cili përfaqëson një tërësi është i ndarë në disa pjesë të ruajtura me emra të ndryshëm. Pjesët e ndara përbëjnë një njësi bibliografike. Në të gjitha rastet e tjera për skedarin me disa emra përsëritet fusha 856 me emrin përkatës të skedarit në nënfushën f. Emri i skedarit mund të përmbaj karaktere gjithëpërfshirëse (p.sh. "*" ose "?") me shënimin në nënfushën z që shpjegon mënyrën e emërimit të skedarit. Te disa sisteme duhet të keni kujdes në shkronjat e vogla dhe të mëdha gjatë shënimit të emrit të skedarit.

Nënfusha mund të përmbaj edhe emrin e botimit elektronik ose të konferencës.

856g Emri uniform i burimit (URN)

Shënohet URN (Uniform Resource Name) e cila paraqet emrin uniform global, pavarësisht nga vendndodhja.

856h Ekzekutuesi i kërkesës (emri i përdoruesit)

Shënohet emri i përdoruesit ose ekzekutuesi i kërkesës që janë të dhënat para simbolit "@" në adresën e strehuesit.

856i Instruksioni

Shënohet instruksioni (komanda) i nevojshëm për përpunimin e kërkesës nga ana e strehuesit në distancë.

856j Bajt për sekondë (BPS)

Shënohet numri më i vogël dhe numri më i madh i bajteve për sekond te transferimi i të dhënave pas lidhjes me strehuesin. E dhëna shënohet në këtë formë: [më së paku BPS]-[më së shumti BPS]. Nëse në dispozicion është vetëm e dhëna për numrin më të vogël, ajo shënohet kështu: [më së paku BPS]-. Nëse në dispozicion është vetëm e dhëna për numrin më të madh, ajo shënohet kështu: -[më së shumti BPS].

856k Fjalëkalimi

Shënohet fjalëkalimi publik për përdorim të përgjithshëm dhe jo fjalëkalimi sekret.

856l Lidhja me rrjetin

Shënohen fjalët të cilat janë kusht për të bërë lidhjen, që kanë përdorim të përgjithshëm dhe janë publike.

856m Ndihma për qasje

Shënohet adresa ose personi i kontaktit për ndihmë gjatë qasjes.

856n Emri i vendndodhjes së strehuesit në nënfushën a

Shënohet vendndodhja e strehuesit nga nënfusha a.

856o Sistemi operativ

Mund të shënohet sistemi operativ të cilin e përdor strehuesi i shënuar në nënfushën a.

856p Porta

Shënohet pjesa e adresës që identifikon procesin ose shërbimin në strehues.

856q Lloji i skedarit

Nënfusha përmban të dhënën për llojin e skedarit ose prezantimin e të dhënave (p.sh. tekst/ HTML, ASCII, postscript, program – exe ose JPEG). Informacioni është për përdoruesit, që të mund të njihen me mundësitë e përdorimit ose leximit të skedarit (p.sh. çfarë softueri ose hardueri nevojitet për shfaqjen e skedarit). Lloji i skedarit përcakton edhe mënyrën e transferimit të skedarit, përkatësisht mënyrën e transferimit të të dhënave në rrjet. Zakonisht skedarët tekst transferohen si të dhëna karakteresh në grupin e karaktereve ASCII (shkrimi bazë latin, numrat nga 0 deri 9, disa karaktere të veçanta dhe shumica e shenjave të pikësimit). Për skedarët tekst me karaktere që nuk i takojnë grupit ASCII ose të dhënat jo tekst (p.sh. programet kompjuterike, imazhet) duhet të përdoret mënyrë tjetër e transferimit, zakonisht mënyra binare. Llojin e skedarit mund ta kërkoni në listat siç është Internet Media Types (MIME types).

 © IZUM, mars 2018, përkthimi në gjuhën shqipe: tetor 2020

856r Parametrat

Vendosen parametrat e përdorur për transferimin e të dhënave. Ata janë:

- numri i bajteve të të dhënave (numri i bajteve për karakter),
- numri përfundimtar i bajteve (numri i bajteve që tregon fundin e një bajti),
- pariteti (pariteti që kontrollon teknikën e përdorur).

Sintaksa e këtyre elementeve është: [pariteti]-[numri i bajteve të të dhënave]-[numri përfundimtar i bajteve]. Nëse ekziston vetëm e dhëna për paritetin vetëm ajo shënohet, pa vizë p.sh. [pariteti]. Nëse është i pranishëm edhe një nga dy elementet e tjera, pas elementit që mungon vendoset viza në vendin e duhur p.sh. [pariteti]--[numri përfundimtar i bajteve] ose [pariteti]-[numri i bajteve të të dhënave]-. Vlerat e paritetit janë: O (Odd – numër tek), E (Even – numër çift), N (None – vlera nuk ekziston), S (Space - hapësirë) dhe M (Mark - shenjë).

856s Madhësia e skedarit

Vendoset madhësia e skedarit, emri i të cilit është vendosur në nënfushën f. Zakonisht ajo shprehet në bajte. Kjo nënfushë përsëritet në rast se përsëritet nënfusha për emrin e skedarit. Në këtë rast nënfusha s është menjëher pas nënfushës f, të cilës i takon.

856t Imitimi i skajshëm

Shënohet imitimi i skajshëm.

856u Vendndodhja unike e burimit (URL)

Shënohet URL (Uniform Resource Locator) që përmban të dhënat për qasjen elektronike në sintaksën standarde. Me adresën URL mund të gjendet njësia elektronike duke përdorur një nga protokollet e internetit (shih shembujt).

856v Orët kur qasja është e mundshme

Shënohet orari (orët), kur qasja në burimin elektronik, në vendndodhjen e shënuar në këtë fushë, është e mundshme.

856w Numri i kontrollit të regjistrimit

Shënohet numri i kontrollit i regjistrimit.

856x Shënimi i brendshëm

Në këtë nënfushë mund të shënohen informacionet që i nevojiten kataloguesit, mirëpo nuk janë të përshtatshme për përdoruesit e bibliotekës.

856y Mënyra e qasjes

Shënohet mënyra e qasjes kur vlera e treguesit të parë është "7". Nënfusha mund të përmbaj mënyrën e qasjes që nuk është një nga tre protokollët kryesorë TCP/IP të specifikuar në treguesin e parë. Të dhënat në këtë nënfushë u përshtaten skemave të publikuara në *Uniform Resource Locators (URL) (RFC 1738)*, përgatitur nga Resource Identifiers Working Group në IETF. The Internet Assigned Numbers Authority (IANA) mirëmban listën e skemave URL si dhe përcakton sintaksën dhe përdorimin e skemave të reja.

856z Shënimi publik

Në këtë nënfushë mund të vendoset shënimi në formën e përshtatshme për t'u shfaqur për përdoruesit e bibliotekës.

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përsëritet kur ka të dhëna të ndryshme për titullin (nënfushat a, b, d) dhe kur ekzistojnë disa mënyra të qasjes. Bibliotekat mund të kenë tituj të ndryshëm URL për të njëjtin burim elektronik. Për këtë arsye fushat ekzistuese 856 që i kanë plotësuar bibliotekat e tjera nuk duhet të ndryshohen, mirëpo të dhënat vendosen në një fushë të re 856, nëse kjo është e nevojshme. Fusha përsëritet edhe kur ekzistojnë disa emra të skedarit (nënfusha a), përveç në rastet kur njësia është është e ndarë në disa pjesë për ruajtje dhe kërkim online.

SHEMBUJ

1.

200	␣1	**a**Russell, **b**Bertrand, **f**1872-1970
856	4␣	**u**http://plato.stanford.edu/entries/russell

2.

210	02	**a**Library of Congress. **b**Copyright Office
856	4␣	**u**http://lcweb.loc.gov/copyright

3.

210	12	**a**International Conference on the Principles and Future Development of AACR2
856	4␣	**u**http://www.nlc-bnc.ca/jsc/

 © IZUM, mars 2018, përkthimi në gjuhën shqipe: tetor 2020

4. * COBISS.net

200	␣1	**a**Vasle **b**Juan
400	␣1	**5**z **a**Vasle **b**Janez
830	␣␣	**a**Fusha e veprimtarisë: këngëtar opere dhe gazetar
856	4␣	**u**http://www2.arnes.si/guest/jvasle
856	0␣	**u**mailto:juan.vasle@guest.arnes.si

9XX BLLOKU I PËRDORIMIT KOMBËTAR

LISTA E FUSHAVE

911 Burimi i emrit*
915 Varianti i palidhur i pikëqasjes – emër vetjak**
916 Shënimi për konvertimin*
950 Pikëqasja në lidhshmëri e palidhur*
990 Rilidhjet*
991 Shënimi i redaktorit*
992 Fusha për nevojat lokale*

Blloku përmban të dhëna me kuptim kombëtar/lokal dhe nuk përdoren për shkëmbim ndërkombëtar.

911 BURIMI I EMRIT*

Fusha përmban disa të dhëna, të cilat ndihmojnë në klasifikimin e regjistrimeve për redaktim. Fusha është krijuar gjatë krijimit automatik të regjistrimeve të njësuara për autorët, në bazë të të dhënave për autorët në regjistrimet bibliografike.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
911		Burimi i emrit*	nr
	a	*Kodi i institucionit/organizatës*	r
	b	*Krijuesi më i shpeshtë*	nr
	c	*Shpeshtësia*	nr

Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

911a Kodi i institucionit/organizatës

Kodi tregon institucionin, në emër të të cilit autori boton veprat dhe i cili përdoret në përgatitjen e bibliografisë së institucioneve.

911b Krijuesi më i shpeshtë

Bëhet fjalë për krijuesin më të shpeshtë nga ajo bazë lokale, i cili deri në ditën e konvertimit fillestar ka krijuar më së shumti regjistrime bibliografike për këtë autor.

911c Shpeshtësia

Shpeshtësia e përsëritjes së emrit të autorit në COBIB në ditën e konvertimit fillestar.

SHEMBUJ

1. *

200	␣1	**a**Butina **b**Vida **r**00105
911	␣␣	**a**4-054 **a**4-006 **b**SURS::ANDREJA **c**9

2. *

200	␣1	**a**Škerget **b**Leopold **r**06428
911	␣␣	**a**3-206 **a**3-112 **a**3-204 **b**KTFMB::MAJA **c**532

 © IZUM, mars 2018, përkthimi në gjuhën shqipe: tetor 2020

915 VARIANTI I PALIDHUR I PIKËQASJES – EMËR VETJAK**

Fusha 915 përdoret në regjistrimet e njësuara, të cilat janë krijuar në mënyrë automatike, bazuar në të dhënat në regjistrimet bibliografike. Gjatë konvertimit fillestar, në fushën e përsëritshme 915 janë transferuar variantet e formave të emrit (variantet e pikëqasjes) nga fushat 901 e 902 në bazën bibliografike, që nuk kanë qenë të lidhura saktë me fushat përkatëse 701 dhe 702 (p.sh. ka munguar nënfusha 7016 për lidhjen e fushave 701 dhe 901, përkatësisht 702 dhe 902).

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
915		Varianti i palidhur i pikëqasjes – emër vetjak**	r
	a	*Elementi hyrës*	nr
	b	*Pjesa tjetër e emrit*	nr
	c	*Shtesa të emrit (jo datat)*	r
	d	*Numra romakë*	nr
	f	*Datat*	nr
	5	*Kodi për marrëdhënien*	nr

Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		***Nuk është i përcaktuar***
2		***Mënyra e shënimit të emrit***
	0	*shënohet vetëm emri ose emri dhe mbiemri*
	1	*shënohet mbiemri dhe emri*

Treguesi përcakton nëse emri është vendosur në renditje të drejtë (vetëm emri ose emri dhe mbiemri) ose në formë të përmbysur (mbiemri dhe emri).

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

Nënfushat nga a deri f janë përshkruar tek fusha 200, ndërsa nënfusha 5 në kapitullin *Nënfushat e kontrollit*.

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Pikëqasja në fushën 915 është varianti i formës së emrit.

Për shkak se të dhënat në fushën 915 janë transferuar në mënyrë automatike nga regjistrimet jo të plota bibliografike, duhet të verifikohet nëse bëhet fjalë për variantin e formës së emrit të vendosur në fushën 200.

SHEMBUJ

1. *

200	␣1	**a**Maček **b**Jože **r**00338
915	␣1	**a**Leskovšek **b**Mirko
		(Fusha 901 në regjistrimin bibliografik nuk ka qenë e lidhur me fushën përkatëse 701, për këtë arsye në fushën 915, në regjistrimin e njësuar, është shfaqur një emër i pasaktë.)

 © IZUM, tetor 2020, përkthimi në gjuhën shqipe: nëntor 2020

916 SHËNIMI PËR KONVERTIMIN*

Në fushën 916 gjatë konvertimit fillestar vendosen shënimet për mangësitë në fushat 70X dhe 90X në bazën bibliografike.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
916		Shënimi për konvertimin*	r
	x	*Teksti i shënimit*	nr

Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

916x Teksti i shënimit

Gjatë konvertimit fillestar në fushën 916 në mënyrë automatike vendosen këto shënime:

- "Lidhje e gabuar me variantin e pikëqasjes në regjistrimin bibliografik <ID e regjistrimit bibl.>", nëse në bazën bibliografike ka ndodhur gabimi gjatë lidhjes së fushës 701, përkatësisht 702 me fushën 901, përkatësisht 902.
- "Për kodin e kërkuesit shkencor në bazën bibliografike ekzistojnë disa variante të emrit", nëse në bazën bibliografike, për një kod të kërkuesit shkencor janë disa forma të emrit në fusha të ndryshme 70X.

SHEMBUJ

1. * COBISS.net

200	␣1	**a**Koler-Povh **b**Teja **r**06926
916	␣␣	**x**Lidhje e gabuar me variantin e pikëqasjes në regjistrimin bibliografik 57244416
916	␣␣	**x**Lidhje e gabuar me variantin e pikëqasjes në regjistrimin bibliografik 114717696
916	␣␣	**x**Për kodin e kërkuesit shkencor në bazën bibliografike ekzistojnë disa variante të emrit.

2. * COBISS.net

200	␣1	**a**Leben-Seljak **b**Petra **r**08630
400	␣1	**a**Seljak **b**Petra Leben-
400	␣1	**a**Leben **b**Petra

916	␣␣	**x**Për kodin e kërkuesit shkencor në bazën bibliografike ekzistojnë disa variante të emrit. *(Gjatë konvertimit fillestar është vendosur shënimi, se në bazën bibliografike, për një kod të kërkuesit shkencor, në fusha të ndryshme 70X janë disa forma të emrit. Në këtë rast bëhet fjalë vetëm për format e ndryshme të emrit të autorit të njëjtë.)*

3. * COBISS.net

200	␣1	**a**Virant **b**Jernej **r**00141
400	␣1	**a**Mraz **b**Miha
916	␣␣	**x**Për kodin e kërkuesit shkencor në bazën bibliografike ekzistojnë disa variante të emrit. *(Gjatë konvertimit fillestar është vendosur shënimi, se në bazën bibliografike, për një kod të kërkuesit shkencor janë disa forma të emrit në fusha të ndryshme 70X. Në këtë rast bëhet fjalë për gabimin në regjistrimin bibliografik, sepse format e emrit janë shumë të ndryshme dhe mesiguri bëhet fjalë për autorë të ndryshëm.)*

 © IZUM, tetor 2012, përkthimi në gjuhën shqipe: tetor 2020

950 PIKËQASJA NË LIDHSHMËRI E PALIDHUR*

Fusha përmban lidhjen me pikëqasjen në lidhshmëri, për të cilën ende nuk është krijuar regjistrimi i njësuar. Fusha do të përdoret për vendosjen e lidhjes së mëvonshme automatike midis regjistrimeve të njësuara, kur ato të krijohen.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
950		Pikëqasja në lidhshmëri e palidhur*	r
	a	*Pikëqasja*	nr
	2	*Kodi i sistemit*	nr
	3	*Numri i regjistrimit*	nr
	5	*Kodi për marrëdhënien*	nr

Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

950a Pikëqasja

Në këtë nënfushë shënohet pikëqasja në tërësi si dhe vendosen të gjitha shenjat e pikësimit që ndodhen midis të dhënave.

9502 Kodi i sistemit

Kodi tregon sistemin e emërtimeve lëndore, të cilit i takon pikëqasja.

9503 Numri i regjistrimit

Nënfusha përmban numrin identifikues të regjistrimit të njësuar nga lista e huaj e emërtimeve lëndore.

9505 Kodi për marrëdhënien

Kodi tregon marrëdhënien midis pikëqasjes në lidhshmëri në fushën 950 dhe pikëqasjes në fushën 2XX.

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha 950 përdoret vetëm në regjistrimet në bazën e njësuar të të dhënave SGC. Kjo fushë plotësohet, kur përmes fushës 5XX duhet të lidhet regjistrimi i njësuar me regjistrimin e njësuar për termin në lidhshmëri, mirëpo kjo nuk është e mundur sepse ky i fundit ende nuk është në bazë. Për këtë arsye në fushën 950 vendosen të dhënat për termin në lidhshmëri, në vend se, për termin në lidhshmëri, të plotësohet fusha 5XX.

Në këtë rast, sipas mundësisë, si lidhje përdoret pikëqasja përkatëse nga lista e emërtimeve lëndore *Library of Congress Subject Headings (LCSH)*, apo nga lista e emërtimeve lëndore *Répertoire d'autorité-matière encyclopédique et alphabétique unifié (RAMEAU)*. Në nënfushën a shënohet pikëqasja, në nënfushën 2 kodi i sistemit LCSH ose RAMEAU dhe në nënfushën 3 numri identifikues nga LCSH ose RAMEAU. Nëse as në LCSH dhe as në RAMEAU nuk ndodhet regjistrimi i duhur për termin në lidhshmëri, në nënfushën a shënohet pikëqasja në gjuhën sllovene, e krijuar sipas rregullave SGC, në nënfushën 2 kodi i sistemit SGC, ndërsa nënfusha 3 lihet e zbrazët.

SHEMBUJ

1. * COBISS.net

250	␣␣	**a**Pllaka argjile
950	␣␣	**2**lc **3**sh 85131815 **5**g **a**Tablets (Paleography) *(Në bazën e të dhënave SGC ende nuk ndodhet termi i gjerë për termin* Pllaka argjile*. Për këtë arsye termi i gjerë nuk mund të shënohet në fushën 550. Në fushën 950 shënohen të dhënat për termin e gjerë, të gjetur në LCSH.)*

2. * COBISS.net

250	␣␣	**a**Ushqimi i shëndetshëm
950	␣␣	**2**ram **3**FRBNF11937798 **5**z **a**Diététique *(Në bazën e të dhënave SGC ende nuk ndodhet regjistrimi për termin në lidhshmëri* Dietologjia*. Për këtë arsye nuk mund të plotësohet fusha 550. Në fushën 950 shënohen të dhënat për termin në lidhshmëri, të gjetur në RAMEAU.)*

 © IZUM, mars 2018, përkthimi në gjuhën shqipe: tetor 2020

990 RILIDHJET*

Fusha përdoret për shënimin e të dhënave që tregojnë se cilat regjistrime bibliografike duhet të rilidhen me disa regjistrime të tjera të njësuara. Fusha përdoret për rilidhjen automatike të regjistrimeve në bazat bibliografike të të dhënave.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
990		Rilidhjet*	r
	a	*Data*	nr
	b	*ID e regjistrimit bibliografik*	r
	n	*ID e regjistrimit të njësuar*	nr

Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

990a Data

Data e rilidhjes shënohet në formën VVVVMMDD.

990b ID e regjistrimit bibliografik

Nënfushat e përsëritshme përmbajnë numrat identifikues të regjistrimeve bibliografike, të cilat duhet të rilidhen me një regjistrim të ri të njësuar.

990n ID e regjistrimit të njësuar

Bëhet fjalë për numrin identifikues të regjistrimit të ri të njësuar.

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Nëse në bazën bibliografike të të dhënave, fushat për personat e ndryshëm me të njëjtin emër janë lidhur gabimisht me regjistrimin e njëjtë të njësuar, këto regjistrime të njësuara duhet të ndahen në disa regjistrime

të njësuara. Në bazën bibliografike duhet të kontrollohen të gjitha regjistrimet, që janë të lidhura në një regjistrim të tillë të njësuar, dhe të shikohet cilat regjistrime, cilit person i takojnë.

Fusha 990 përdoret në rastet kur numri i regjistrimeve bibliografike që duhet të rilidhen është i vogël. Shumica e regjistrimeve bibliografike mbeten të lidhura me regjistrimin përkatëse të njësuar, ndërsa për personat e tjerë krijohen regjistrimet e njësuara shtesë.

Në regjistrimin e njësuar ekzistues, për çdo regjistrim të ri të njësuar shtohet nga një fushë 990 me ID-në e regjistrimit të ri të njësuar në nënfushën n dhe me ID-të e regjistrimeve bibliografike, të cilat duhet të lidhen me të, në nënfushat e përsëritshme b. Gjatë bashkërendimit të bazës bibliografike me atë të njësuar, në këto regjistrime bibliografike, lidhja me ID-në e regjistrimit të njësuar të ndarë zëvendësohet me lidhjen me ID-në e regjistrimit të ri të njësuar.

SHEMBUJ

1. *

